

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7857 E shtunë 20 Prill 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga FATOS ÇOÇOLI

## Armëpushim?



Që nga 21 shkurti, opozita e vetël-arguar nga Parlamenti na kishte mësuar të protestonte çdo ditë që Kuvendi mbledhë në seancë plenare. Nganjëherë edhe ...  
Vijon në faqen 20

Opinion

Ditës

Nga PETRIT VASILI

## Attention! Zgjedhjet nuk janë fushata grumbullimi patatesh



Attention!!! Zgjedhjet nuk janë fushata grumbullimi patatesh të kalbura të krimi!!! Attention!! Ca të huaj po mëtojnë të promovojnë standarde ...  
Vijon në faqen 21



Ambasada: Kuvendi vazhdon të funksionojë

## SHBA: Nxisim këdo të futet në zgjedhje, përsëritje grupet e reja në parlament

Opozita/ Mediu dhe Shehi: Marrëveshje me PS me kusht që të largohet Edi Rama

Ambasada amerikane në Tiranë nxit këdo që mendon të kandidojë që të regjistrohet në zgjedhjet vendore të 30 qershorit. Në përgjigje të interesimit të "Zërit të Amerikës" për qëndrimin e ambasadës së Shteteve të Bashkuara ndaj zgjedhjeve vendore dhe pjesëmarrjes së partive të opozitës, ndërkohë që afati për regjistrimin pranë Komisionit Qendror të ...  
Në faqen 3

## UNAZA E RE/ VENDIMI I PLOTE, PARATE PER ATA QE DO U PRISHEN SHTEPITE

# PRONARET, FAMILJET QE NDAJNE 10 MILIONE EURO

Emrat, vlera që përfitojnë 146 pronarët e ndërtimeve nga "Pallati me Shigjeta", te rrethrotullimi, te "Shqiponja". Kompensimi për tokën truall, arë dhe godinën



(Në foto) Punimet për ndërtimin e unazës së madhe

DEKRETI I PRESIDENTIT

Meta kthen në Kuvend vetëkund në polici: Ka terren për ndikim politik

Në faqen 2

DRAMA

Lindi binjakë në vitin 1982, nëna: Më thanë vdiqën, nuk i pashë kurrë

Në faqen 6

PROJEKTILIGJI

Amnistia në burgje, ministria ndryshon draftin, ja kush do të përfitojë

Në faqen 4

PRIVATIZIMI

Ligji i ri, qeveria i hap rrugën blerjes së pronave shtetërore

Në faqen 5

KONTROLLE NE FUSHE-KRUJE



Grabitja në Rinas, kush janë dy të dyshuarit e tjerë, lidhja me Muratajn

Në faqen 7



Modelja spanjolle dhe moderatorja afrikane, fotografitë në resortin e njohur

## VIP-at botërorë, pushime në "Prestige Resort"

Në brendësi: Saimir Tahiri, baba për herë të dytë. Rrëfihet Marina Fara

Një bionde sensuale dhe një brune seksi kanë bërë përshtypje me pamjen dhe prezencën e tyre, pasi kanë vendosur të akomodohen për të pushuar në resortin "Prestige" tek Mali i Robit. Fjala është për dy vajza të famshme në botë, missin dhe modelen bionde



Natalia Bush si dhe prezantuesen televizive nga Afrika e Jugut, Bonang Matheba. Nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën pasi secila ka famën e saj, por në këtë rast i ka lidhur zgjedhja e njëjtë për të pushuar pranë detit duke prenotuar dhomat ...  
Suplement

Suplement

## VETINGU NË POLICI PRESIDENTI

Ndryshimet, presidenti: Nuk garanton paanshmëri, krijohet terren për ndikim politik

# Meta kthen në Kuvend ligjin për vetingun në polici

"Qeveria kërkon të kontrollojë procesin"

Valentina Madani

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, për të dytën herë refuzon Sander Lleshajn. Kreu i Shtetit rikthehe dje për rishqyrtim në Kuvend ligjin për vetingun në polici, pas ndryshimeve të bëra nga ana e ministrit të Brendshëm. Sipas kreut të shtetit, këto amendime të miratuara në fund të muajit mars cenojnë parimet dhe standardet e ligjit ekzistues, si dhe nuk krijojnë garancitë e nevojshme se një proces kaq i rëndësishëm si vlerësimi kalimtar i punonjësve të Policisë së Shtetit dhe të Gardës së Republikës do të realizohet në kohën e duhur, me objektivitet dhe paanshmëri, duke bërë hapa pas në raport me standardet e ligjit në fuqi. Meta argumenton se në këtë mënyrë krijohet terren që ky proces të ketë ndikim politik. Këtë shqetësim edhe pse jo në formë kaq të hapur e shprehu në Kuvend dhe ish-ministri Fatmir Xhafaj në seancën ku u miratuan ndryshimet. Sipas Ilir Metës, ky ligj cenon parimet dhe standardet e vendosura në Policinë e Shtetit. "Ndryshimet e miratuara me këtë ligj nuk krijojnë garancitë e nevojshme se një proces kaq i rëndësishëm si vlerësimi kalimtar i punonjësve të Policisë së Shtetit dhe të Gardës së Republikës do të realizohet në kohën e duhur, me objektivitet dhe paanshmëri, duke bërë hapa pas në raport me standardet e ligjit në fuqi", - theksoi kreu i shtetit. Argumentet e Presidentit të Republikës për kthimin e këtyre ndryshimeve janë ato të mos garantimit të realizimit në kohën e duhur dhe me paanshmëri të këtij procesi të rëndësishëm. Amendimet e miratuara mbi këtë ligj cenojnë standardet e vendosura dhe pavarësinë e procesit si dhe krijon terren për ndikim politik", - argumenton kreu i shtetit, i cili shkoi me tej duke shpjeguar se ndryshimet e fundit në ligj krijojnë bindjen se qëllimi real i qeverisë në ndërmarrjen e kësaj nisme ligjore nuk është



Presidenti i Republikës, Ilir Meta

### VETINGU

"Ndryshimet e miratuara me këtë ligj nuk krijojnë garancitë e nevojshme se një proces kaq i rëndësishëm si vlerësimi kalimtar i punonjësve të Policisë së Shtetit dhe të Gardës së Republikës do të realizohet në kohën e duhur, me objektivitet dhe paanshmëri, duke bërë hapa pas në raport me standardet e ligjit në fuqi", - tha z. Meta.

## Burri i deputetes së PS, prokuror në Tiranë. PD: KLP-ja shkeli Kushtetutën

Partia Demokratike nëpërmjet ish-deputetit Enkelejd Alibeaj akuzoi dje Këshillin e Lartë të Prokurorisë se ka emëruar prokuror bashkëshortin e deputetes socialiste, Ermonele Pelaj, në shkellje të Kushtetutës. Alibeaj, ish-ministër i Drejtësisë tha se Bledar Valikaj është emëruar nga KLP-ja në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet e reformës në drejtësi. Sipas ligjit themelart të shtetit, KLP-ja mund të emërojë një prokuror vetëm pas përfundimit të shkollës së Magjistraturës. Ndërsa sipas ligjeve të reformës në drejtësi, emërimi i një prokurori nuk mund të bëhet pa kaluar në procesin e vetingut. Sipas Alibeajt, bashkëshorti i ish-



ministres së Ramës nuk plotëson asnjë nga këto kriteret. Ish-deputeti Enkelejd Alibeaj theksoi se KLP-ja në kundërshtim me Kushtetutën, "ka emëruar prokuror ushtarin e Edi Ramës pa bërë më parë veting dhe pa mbaruar magjistraturën". "Rasti i Bledar Valikajt, merita e vetme e të cilit

është lidhja bashkëshortore me deputetin e Edi Ramës përbën një provë skandaloze sesi organet e reja të drejtësisë shkelin Kushtetutën për t'i shërbyer pushtetit të kryeministrit, përmes kësaj politike të çlo halke të sistemit të drejtësisë", - tha z. Alibeaj.

të zvogëlimi i kostove financiare, por vullneti për ta kontrolluar procesin nëpërmjet një strukture vlerësuese në varësi të saj, si SHÇBA. Njëkohësisht, për kreun e shtetit, mungesa e një afati kohor për përfundimin e procesit të rivlerësimit, krijon mundësinë e zgjatjes së tij pa afat dhe terren të përshatshëm për mbajtjen nën presion të forcave policore përmes

forcës ndëshkuese të mekanizmit të vlerësimit kalimtar nga struktura në varësi të Ministrisë së Brendshme. Duke u rikthyer ligjit të ish-ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj, presidenti nënvizon se ligji i parë është hartuar dhe bashkëpunuar nga të gjitha palët politike, ndërsa ndryshimet janë bërë me një parlament, ku PD-ja dhe LSI-ja janë jash-

të parlamentit. "Ky ligj është votuar me 88 vota pro, 1 kundër dhe 32 deputetë kanë abstenuar, duke reflektuar kështu një terren bashkëpunues dhe jo kundërshtues midis forcave politike në Kuvendin e Shqipërisë", u shpreh z. Meta. Argumenti i Këshillit të Ministrave për uljen e kostos për realizimin e këtij procesi nuk e ka bindur kreun e shtetit. Sipas ar-



Opozita e re në Kuvend

### NDRYSHIMET

"Qëllimi real i qeverisë nuk është zvogëlimi i kostove financiare për realizimin e këtij procesi, por vullneti i shprehur i saj për ta kontrolluar këtë proces nëpërmjet një strukture vlerësuese në varësi të saj, siç është Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave, strukturë aktuale kjo drejtpërdrejt në varësi të funksionit politik të ministrit të Brendshëm", - theksoi Meta.

## LSI, Vasili: Liria e medias u shkatërrua, po shkojmë në greminë

Ish-kreu i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, akuzoi dje kryeministrin Edi Rama për shkatërrim të lirisë së medias. Duke komentuar raportin e "Reportereve pa Kufij", Vasili tha se në Shqipëri gazetaret janë kërcënuar me vdekje për të mos nxjerrë në pah korrupsionin e qeverisë. "Goditja e Edi Ramës është përqendruar dhe të pushtetit i katërt tashmë, pasi ka rrëmbyer drejtësinë, pasi ka rrëmbyer parlamentin dhe e ka kthyer në një sport të karavandesh, ka rrëmbyer ekzekutivin dhe betejat e fundit është me media, me pushtetin e katërt, e cila është edhe dritarja ku shqiptarët mësojnë mbi të vërtetat. Ata që duhet të hetojnë mbi fajet e Edi Ramës nuk hetojnë për korrupsionin. Por nuk kanë turp, duke filluar nga prokurorja e përgjithshme, kur truprojat e saj dhunojnë njerëzit e medias, siç ndodhi me gazetarin Sali Jani. Këto bënë që për herë të parë gazetaret të protestojnë përpara prokurorisë. Gjë e pa ndodhur në historinë e pluralizmit shqiptar", deklaroi z. Vasili.



syetimit të Metës, mazoranca kërkon kontrollin e procesit. "Qëllimi real i qeverisë nuk është zvogëlimin i kostove financiare për realizimin e këtij procesi, por vullneti i shprehur i saj për ta kontrolluar këtë proces nëpërmjet një strukture vlerësuese në varësi të saj, siç është Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave, strukturë aktuale kjo drejtpërdrejt në

varësi të funksionit politik të ministrit të Brendshëm", deklaroi kreu i shtetit. Sipas presidentit, argumenti i Këshillit të Ministrave se ky mekanizëm i ri garanton të njëjtin standard për të gjithë procesin, pasi punonjësit e SHÇBA-së do t'i nënshtrohen të njëjtit proces në fazë të parë dhe se nuk ndryshojnë kriteret dhe procedurat e vlerësimit nuk qëndron ligjërish.



Ambasada përshëndet opozitën në parlament: Kuvendi vazhdon të funksionojë

# Zgjedhjet, ambasada e SHBA: Nxisim këdo të regjistrohet

"Konkurrim demokratik të hapur në rutinë e votimit"

Ambasada amerikane në Tiranë nxit këdo që mendon të kandidojë që të regjistrohet në zgjedhjet vendore të 30 qershorit. Në përgjigje të interesimit të "Zërit të Amerikës" për qëndrimin e ambasadës së Shteteve të Bashkuara ndaj zgjedhjeve vendore dhe pjesëmarrjes së partive të opozitës, ndërkohë që afati për regjistrimin pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve po afrohet, e ngarkuara me punë, Leyla Moses-Ones, solli në vëmendje deklaratat e Zëvendësndihmës Sekretarit Matthew Palmer në Tiranë, i cili siç theksoi diplomatja amerikane, "u bëri thirrje atyre partive që kanë braktisur institucionet e Shqipërisë që të riangazhohen në procesin politik. Pjesëmarrja në zgjedhjet vendore të qershorit është mundësia më e mirë për ta që ta bëjnë këtë". E ngarkuara me punë u shpreh për "Zërin e Amerikës" se "ambasada mirëpret konkurrimin demokratik, të hapur dhe energjik në rutinë e votimit. Votuesit shqiptarë duhet të kenë mundësinë të zgjedhin mes një game të gjerë kandidatësh që do t'i përfaqësojnë vërtetë ata", tha ajo.



Zëvendësambasadorja amerikane, Leyla Moses-Ones

**DEKLARATA**  
Leyla Moses-Ones, e ngarkuara me punë u shpreh për "Zërin e Amerikës" se ambasada "mirëpret konkurrimin demokratik të hapur dhe energjik në rutinë e votimit. Votuesit shqiptarë duhet të kenë mundësinë të zgjedhin mes një game të gjerë kandidatësh që do t'i përfaqësojnë vërtetë ata", tha ajo.

**RUDINA HAJDARI**

Deputetja Rudina Hajdari riktheqsoi se është kundër bojkotimit të zgjedhjeve, që pritet të mbahen në 30 qershor. Në një postim në "Twitter", Hajdari e konsideron këtë veprim si një vetëvrasje politike, ndërsa shton se sipas saj, e vetmja rrugë për të ndryshuar pushtetin në një vend demokratik janë zgjedhjet.

**Sigla e PD? Mustafaj: Rama, përpjekje për t'ia lënë Hajdarit**

Ish-ministri i Jashtëm, Besnik Mustafaj, dje në "News 24" e quajti harxhimin energjisht dhe spekulim nëse do kishin një luftë për siglën e PD-së mes Bashës dhe Rudina Hajdarit, ndërsa shtoi se kryeministri Edi Rama do bënte gjithçka për t'ia lënë siglën Hajdarit. "E vetmja gjë e pakuptueshme për mua është që nuk do lejojmë të zhvillohen zgjedhjet. Kjo më duket e pamundur. Në qoftë se Basha dhe PD kanë parasysh pengmarrjen nëpërmjet komisionerëve, kjo nuk është e mundur, sepse ligji i ka dalë para për zëvendësimin e komisionerëve. Për forma të tjera nuk jam dakord. Në statutin e PD-së përcaktohet qartë kush e përdor siglën. Deputetët e LSI dolën të pavarur. Do ishte spekulim, harxhim energjisht, nëse fillon një luftë për siglën. Ne kemi eksperiencën komike në historinë shqiptare kur Pollo krijoi PDR, kur e lejuan të përdorte PD dhe një "R" të vogël, duke krijuar konfuzion në elektorat. Nëse zonja Hajdari dhe Basha do të fillojnë një përplasje mes tyre, unë parashikoj që Rama do bëjë gjithçka për t'ia lënë siglën politike zonjës Hajdarit. Kjo do ishte e pandershme, do ishte mirë të mos ndodhte", u shpreh Mustafaj. Sa u përket zgjedhjeve dhe plotësimin të kushteve të kërkuara nga opozita, Mustafaj tha se nëse do kishte vullnet, ndryshimet mund të bëheshin edhe për dy javë. "Nëse flasim për kohën që do t'iu duheshin ndryshimeve... Nuk i kemi shumë të qarta kushtet që ka parasysh lideri i opozitës. Në parim unë di që të gjitha këto ndryshime bëhen edhe për dy javë, mjafton të ketë vullnet nga të dyja palët. Jo vetëm nga qershori në vjeshtë, por edhe nga qershori në korrik, koha është plotësisht e mundshme, vullneti ende nuk shihet", deklaroi Mustafaj.

**Mediu e Shehi: Marrëveshje me PS, kusht largimi i Ramës**

**Bojkoti, aleatët e PD zbardhin skenarin: Do të tërheqim komisionerët nga qendrat e votimit**

Një ditë pasi Lulzim Basha deklaroi se opozita do të pamundësojë zgjedhjet e 30 qershorit nëse ato nuk do jenë të lira e të ndershme, aleatët e opozitës nuk ngurojnë të zbardhin disa prej skenarëve. Republikani Fatmir Mediu dhe kreu i LZHK-së, Dashamir Shehi, u shprehën se futjen e opozitës në zgjedhje e garanton një marrëveshje e gjerë me Partinë Socialiste, që si kusht kryesor ka qeverinë tranzitore pa Edi Ramën kryeministër. Mediu e Shehi kërkojnë që çdo marrëveshje të ketë parasysh këto kërkesa dhe të mos jetë e ngjashme me atë të vitit 2017. Ky qëndrim i aleatëve të Lulzim Bashës vjen pas kushtëzimit që Partia Demokratike bëri për pjesëmarrjen në zgjedhjet lokale, duke e cilësuar largimin e kryeministrit Edi Rama dhe organizimin e një procesi të lirë dhe demokratik, si parakusht për regjistrimin e saj në garën për vendoret. "Nuk mund të ketë kuptim



që ne dogëm mandatet për të kërkuar zgjedhje të lira dhe të ndershme, të futemi në proces zgjedhor farsë", deklaroi z.Mediu. Kurse kreu i LZHK-së, Dashamir Shehi, u shpreh: "Kjo do të ishte e pa-justifikueshme. Ne dolëm nga parlamenti se nuk kishte kushte politike për të ushtruar jetën parlamentare". Duket se opozita krahas bojkotit, ka menduar edhe mekanizmat se si do të pamundësojë mbajtjen e zgjedhjeve. "Do tërheqim komisionerët nga qendrat e votimit", tha z.Shehi. Kreu i LZHK-së, Dashamir Shehi, krahas betejës që opozita po

zhvillon, kërkon që pjesë e paketës për zgjedhje të lira të jetë edhe sistemi. Kreu i republikanëve, një mesazh kishte edhe për grupin më të ri parlamentar "demokrat", që shprehu gatishmërinë për të garuar në 30 qershor: "Njerëzit që i bashkohen marrëzisë së të marrit do të kenë të njëjtin fat siç është i marri", tha z.Mediu. Brenda këtyre ditëve pritet që PD-ja të firmosë me gjithë partitë opozitare një marrëveshje politike, pjesë e së cilës është qëndrimi në raport me zgjedhjet lokale në qeverinë "Rama".

pas Partisë Demokratike, "kriza e rëndë politike në vend nuk mundëson standartet demokratike për zgjedhje të lira dhe të ndershme". Por, përveç mospjesëmarrjes, PD-ja sipas propozimit të zotit Basha do të angazhohet edhe për të bllokuar zhvillimin e zgjedhjeve. "Partia Demokratike e Shqipërisë angazhohet në mbrojtje të

demokracisë dhe të drejtës së votës së lirë që të mos lejojë përveç zgjedhjeve të lira, asnjë farsë elektorale", thuhet në vendim ndërsa saktësohet se angazhohet gjithashtu dhe që "të pamundësojë përmes përshkallëzimit të aksionit opozitar dhe qytetar, mbajtjen e zgjedhjeve fasadë, të diktuara nga krimi i organizuar dhe paratë e pista që

shkatërrojnë demokracinë dhe vullnetin e qytetarëve shqiptarë". Në të njëjtin linjë ishte dhe LSI-ja. "Aksioni politik i LSI-së, i inkuadruar në tërësinë e veprimit politik dhe qytetar të opozitës do të vazhdojë me vendosmëri për të mos lejuar që në këtë vend të ketë më zgjedhje farsë", deklaroi nënkryetari Luan Rama.

**SHOQËRIA PËRMBARIMORE GJYQËSORE "3H" Sh.p.k**  
Rr: "Tish Daja", Kompleksi Kika 2, Kulla 5, Kt. 1, Tiranë  
Web: www.3h-si; Email: shqg\_3h@yahoo.com; tel:0692099711

Njefton shpalljen e ankandit nga dt.16.04.2019 deri ne dt. 24.04.2019 per: sendin e luajtshem- automjetin terheqes Renault me Targa AA 245 OE, model Magnum 480 me cmim fillestar 751,800.00 Leke automjetin gjysmë rrimorkjo marka Fruehauf TD 35, me Targa AER 831 me cmim fillestar 98,800.00 Leke ne pronesi te Subjektit Klodian Xhani PF me NIPT L02025004L. **Ankandi zhvillohet ne zyrën permbarimore ne daten 24.04.2019 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00**

## PROJEKTLIGJI BURGJET

Ministria e Drejtësisë bëri të ditur se grupi ndërinstitucional po rishqyrton projektligjin

# Amnistia e të burgosurve, ministria ndryshon draftin

Qeveria kërkon ta miratojë me votat e opozitës së re

Grupi ndërinstitucional Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme dhe Prokuroria është mbledhur sërish për të diskutuar edhe një herë kriteret dhe kushtet që duhet të përmbushin të burgosurit për të përfutuar nga amnistia. Këtë fakt e bëri të ditur dje ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj, e cila duke iu përgjigjur interesit të mediave theksoi se amnistia do të kalojë në qeveri për miratim, por më parë do të rishqyrtohet edhe një herë nga grupi ndërinstitucional. Ajo theksoi se ky grup ka vijuar takimet për të parë jo vetëm kriteret, por edhe për të bërë përllogaritjet se sa individë përfitojnë prej amnistisë. Kjo, pasi sipas saj, situata në burgje është dinamike dhe numri i atyre që përfitojnë mund të ndryshojë nga muaji në muaj. "Amnistia po ripunohet për shkak se treguesit dhe të dhënat e të dënuarve janë dinamike dhe ndryshojnë muaj pas muaji dhe grupi i punës që është i përbërë nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme dhe Prokuroria është mbledhur përsëri për të parë si sh-



Ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj dhe kryetari i Bashkisë së Vlores, Dritan Leli

### DRAFTI

"Amnistia po ripunohet për shkak se treguesit dhe të dhënat e të dënuarve janë dinamike dhe ndryshojnë muaj pas muaji dhe grupi i punës, që është i përbërë nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme dhe Prokuroria është mbledhur përsëri për të parë si shkojnë shifrat dhe cilët janë personat apo grupi i subjekteve që duhet të përfshihen në këtë amnistia", - tha Gjonaj.

kojnë shifrat dhe cilat janë personat apo grupi i subjekteve që duhet të përfshihen në këtë amnistia", - tha Gjonaj. Ajo konfirmoi edhe një herë se amnistia do të

kalojë në qeveri për miratim dhe më pas edhe në Kuvend, ku do të kërkohet edhe vota e opozitës së re për ta kaluar. Por, sipas saj, koha e kalimit të amnistisë do të varet edhe nga ndikimi që mund të ketë ajo në fushatën elektorale. Për të shmangur interpretimet se ajo bëhet për qëllime elektorale, ministria e Drejtësisë la të kuptohet se mund të miratohet edhe pas zgjedhjeve. "Amnistia ka qenë gati që në muajin nëntor 2018 për t'u miratuar nga qeveria, por për shkak se nuk kemi pasur vullnetin e opozitës se atëherëshme për të miratuar amnistinë e cila është shumë e nevojshme, nuk u arrit dot të miratohej, sepse nuk kishim shumicën e cilësuar të nevojshme për ta votuar në parlament. Në këtë situatë ku kemi një opozitë, pra deputetë të dy grupeve të reja opozitare në parlament po shikojmë mundësinë që ta dërgojmë përsëri për miratim nëpërmjet kalimit nga qeveria, duke krijuar dhe duke pasur parasysh dhe duke matur edhe ndikimin që mund të ketë në fushatën elektorale", - u shpreh Gjonaj nga Vlora, ku mori



Gjatë një mbledhjeje të qeverisë

pjesë në firmosjen e një marrëveshjeje bashkëpunimi me bashkinë e këtij qyteti. Sipas draftit fillestar, nga amnistia parashikohet të përfitojnë rreth 350 të burgosur që vuanë dënime të ndryshme në burgjet e Shqipërisë. Sipas projektligjit, parashikohet të përfitojnë nga amnistia të gjithë ata persona që nuk kanë kryer vepra të rënda penale, ose ata në moshë të madhe, ose për ata që në momentin e kryerjes së veprës kanë qenë më të vegjël se 18 vjeç. Projektligji parashikonte që të amnistonte të gjithë personat e dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim deri në 3 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë, duke përfshirë gjobën, pez-

llimin e dënimit me burgim ose çdo lloj dënimi tjetër alternativ. Por, që këta persona të përfitonin nga kjo dispozitë, duhet që dënimet e formës së prerë të ishin dhëna brenda një afati të caktuar. Ndërkohë që sipas draftit fillestar, amnistoheshin të gjithë personat e dënuar me burgim, të cilëve deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit u kanë mbetur pa vuajtur një periudhë deri në dy vite burgim. Po ashtu do të amnistoheshin personat e dënuara femra, që në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji ishin bars ose mbi moshën 55 vjeçe, si dhe personat e dënuar meshkuj, që në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji ishin bars ose mbi moshën 60 vjeç.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BANKA E SHQIPERISE  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

### TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit të kondicionimit në godinën qëndrore të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 3,400,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit të kondicionimit në godinën qëndrore të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 13 Maj 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BANKA E SHQIPERISE  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

### TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të asensorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 1,840,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të asensorëve në godinat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 14 Maj 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



**T**ë gjithë ata individë apo subjekte private që kanë një pronë, që kufizohet nga prona shtetërore do kenë mundësi t'i blejnë ato. Qeveria ka paraqitur në Kuvend një nismë të veçantë ligjore, që mundëson që privatët të mund të blejnë ato toka apo prona shtetërore që janë në kufijtë e pronës së tyre, me qëllim mundësimin e zhvillimit të pronave si një e tërë. Nisma ligjore e qeverisë përbëhet nga vetëm dy nene që vijnë si shtesa në aktin normativ, me fuqinë e ligjit, nr.4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore të xhiros së këtyre ndërmarrjeve".

**PROBLEMATIKA**

Kjo nismë merr shkas nga vullneti për të adresuar disa problematika që ndeshen aktualisht me disa sipërfaqe toke shtetërore, të cilat preken nga planet e përgjithshme vendore. Konkretisht, në mjaft raste ekzistojnë sipërfaqe të ndryshme toke, pronë private, të cilat janë të përfshira në planet e miratuara të zhvillimit urban nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore. Por, këto sipërfaqe toke private rrethojnë, prekin ose janë menjëherë në kufi me copëza/sipërfaqe relativisht të vogla toke, në pronësi të qeverisjes qendrore ose të njësive të vetëqeverisjes vendore. Në praktikë, këto rrethana sjellin probleme për investitorët, që përkthehen me pengesa në kryerjen e disa investimeve të rëndësishme në vend, si dhe sjellin si rezultat moszbatimin e planeve vendore të miratuara. Kjo, sepse investimet private pengohen nëse investimi nuk do të përfshinte edhe këto sipërfaqe të vogla shtetërore, një pjesë e mirë e të cilave prej kohësh rezultojnë të ketë humbur

Qeveria ka paraqitur nismën që i mundëson privatit privatizimin e pronës shtet

# Ndryshon ligji, i hapet rruga blerjes së pronave shtetërore

*Projektligji amendon Aktin Normativ të 2008-ës*



Foto ilustruese

**PRONA**

Në praktikë këto rrethana sjellin probleme për investitorët, që përkthehen me pengesa në kryerjen e disa investimeve të rëndësishme në vend, si dhe sjellin si rezultat moszbatimin e planeve vendore të miratuara. Kjo, sepse investimet private pengohen nëse investimi nuk do të përfshinte edhe këto sipërfaqe të vogla shtetërore, një pjesë e mirë e të cilave prej kohësh rezultojnë të ketë humbur edhe funksionet për të cilat janë përdorur dikur.

edhe funksionet për të cilat janë përdorur dikur. Vlen të përmendim këtu se problematika e regjimit të pronës në Shqipëri dhe e sigurisë juridike që lidhet me pronat është një problematikë e kaqershme dhe e trashëguar, që fatkeqësisht vazhdon ende të pengojë realizimin e shumë investimeve me potencial të lartë për vendin.

**PROJEKTILIGJI**

Ky projektligj është i strukturuar në 2 nene. Konkretisht, shtesa e parë bëhet në paragrafin e dytë të nenit 2, ku në fjalë të parë, pas fjalës "... tenderit..." shtohen fjalët "... ose tjetërsimit ...". Synimi i kësaj shtese është zgjerimi i konceptit të privatizimit të parashikuar në aktin normativ, që krahas

formës së privatizimit me mënyrën e tenderit, të parashikojë edhe formën e privatizimit me metodën e "tjetërsimit", siç do të jepet në dispozitat e reja që paraqiten në vijim. Tjetërsimi bëhet nëpërmjet kontratave të tjetërsimit, ku pronësia mbi pasurinë kalon në çastin e lidhjes së kontratës së tjetërsimit të kësaj pasurie. Blerësi apo përfituesi i kësaj pasurie bëhet pronari i ligjshëm i saj që në momentin e nënshkrimit të kontratës, duke fituar të gjitha të drejtat dhe detyrimet që

lidhen me qenien e tij si pronar mbi këtë pasuri. Ndryshimi i dytë prek sërish nenin 2 të aktit normativ, ku në fund të fjalës së dytë, pas fjalëve "... Këshillit të Ministrave..." shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: "Kalimi i pronës shtetërore në private të bëhet edhe në funksion të planeve të përgjithshme vendore, sipas kushteve dhe kritereve që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Vendimi i Këshillit të Ministrave për këto raste përcakton gjithashtu kushtet që duhet të plotë-

sojnë kërkuesit e tjetërsimit me kontratë të pronës shtetërore, mënyrën e vlerësimit të pronës shtetërore si dhe organet që përfshihen gjatë procesit dhe rolin e tyre". Thelbi i ndryshimeve të propozuara bën të mundur që në ligj të parashikohet mundësia e privatizimit të sipërfaqeve të pronës shtetërore tek të tretët, në funksion të planeve të përgjithshme vendore të miratuara, si dhe sipas kushteve e procedurave që do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

**PROJEKTILIGJI**

**Neni 1**

Në nenin 2 bëhen shtesat me këtë përmbajtje:  
 1. Në paragrafin e dytë, në fjalë të parë, pas fjalës "... tenderit..." shtohen fjalët "... ose tjetërsimit...".  
 2. Pas paragrafit të dytë shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:  
 "Kalimi i pronës shtetërore në private të bëhet edhe në funksion të planeve të përgjithshme vendore, sipas kushteve dhe kritereve që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Vendimi i Këshillit të Ministrave për këto raste përcakton gjithashtu kushtet që duhet të plotësojnë kërkuesit e tjetërsimit me kontratë të pronës shtetërore, mënyrën e vlerësimit të pronës shtetërore si dhe organet që përfshihen gjatë procesit dhe rolin e tyre".

## Hahn: Legjislacioni i pronave mbetet shumë i fragmentarizuar

**K**omisioneri i BE, Johannes Hahn, në një intervistë për "DW" u shpreh se kuadri ligjor për të drejtat e pronës në Shqipëri ka dobësi ligjore dhe teknike. Sipas tij, ende edhe gati 30 vite nga rënia e regjimit komunist, Shqipëria nuk ofron siguri juridike për pronat dhe se kuadri ligjor që e trajton këtë çështje është i komplikuar. "Përmbyllja e sigurisë ligjore dhe qartësia e titujve të pronësive nuk është arritur ende plotësisht, pavarësisht nga vazhdimi i përpjekjeve për arritjen e tyre. Copëzimi, fragmentarizimi ligjor, zbrastëtitë në sistemin e regjistrimit dhe zbatimi i tij në këtë fushë mbeten të adresohen në të gjithë vendin", - tha Hahn. Ai është ndalur edhe te dy nismat e fundit ligjore të qeverisë, që trajtojnë çështjen e pronës në bregdet,



përfshi edhe atë të minoritetit grek të pretenduar se jeton në zonën e Himarës. Sipas tij, KE është duke e ndjekur me vëmendje këtë situatë, ndërsa bën apel që çdo nismë e tillë të jetë e mirëpranuar dhe gjithëpërfshirëse. "Komisioni Europian është i vetëdijshëm për shqetësimet ndaj vendimeve të fundit, të miratuara nga qeveria shqiptare, lidhur me menaxhimin e tokës përgjatë zonës jugore bregdetare dhe vazhdon të angazhohet me autoritetet kompetente në këtë drejtim. Duke pasur parasysh rëndësinë e temës në vend, është vendimtare që çdo masë e mëtejshme të jetë pjesë e një procesi të hapur dhe gjithëpërfshirës dhe të përshatet në një plan të strukturuar reformash", tha Hahn. Më tej, ai shtoi se të drejtat e pronësive po monitorohen nga BE-ja si pjesë e kuadrit të të drejtave themelore të njeriut dhe se Komisioni Europian po shqyrton mundësitë ta mbështesë Shqipërinë në trajtimin e situatës problematike lidhur me të drejtën e pronës, në linjë me standartet ndërkombëtare.



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BANKA E SHQIPERISE**  
 DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
 SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR I SHOQERUAR ME FTESA DIREKTE KANDIDATEVE TE HUAJ**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shtypja e monedhave metalike përkujtimore për qëllime numizmatike '200 Lekë' dhe '100 Lekë', pa kurs ligjor, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar i shoqeruar me ftesa direkte kandidatëve të huaj", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 54,345,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një bankë tregtare në Illogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
 BIC: STANALTR  
 IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shtypja e monedhave metalike përkujtimore për qëllime numizmatike '200 Lekë' dhe '100 Lekë', pa kurs ligjor, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 23 Maj 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

**GREQI** - Avokati i njohur grek, Aleksandros Likurezos u vu në pranga pasditen e së premtes në Athinë, i akuzuar për implikim në të ashtuquajturën "Mafie e burgejeve". Sipas burimeve mediatike, akuzat kundër tij janë për krijim organizate kriminale dhe shantazhim. Arrestimi ka ardhur pasi më herët kolegë të tij, kishin deponuar se pak para vrasjes së avokatit Mihalis Zafeiropoulos në tetor



Avokati Aleksandros Likurezos

## Pranga avokatit të njohur grek, kërkoi 2 milionë euro për llogari të Klodian Lekocajt

2017, Likurezos kishte folur me të në telefon. Siç kanë deponuar në gjyqin për çështjen Zafeiropoulos të paktën dy avokatë-dëshmitarë, Likurezos i kishte kërkuar kolegut që do të ekzekutohej më vonë nga dy shqiptarët, një shumë të madhe parash për llogari të "bos-it" të "mafies së burgejeve",

siç është quajtur nga media shqiptarit Klodian Lekocaj. Avokatët kanë thënë se shuma e kërkuar ishte 2 milionë euro. Lekocaj dyshohet të ketë qenë porositësi i intimidimit të Zafeiropoulos, vrasja e të cilit ishte pasojë e një aksidenti, siç ka pretenduar ekzekutori Mikel Brahimaj. Porosia ishte dhënë bashkë

me Arbër Bakon, i cili u vra po me porosi të Lekocajt më 14 janar të këtij viti në burgun e Koridhalo. Një person me influencë të madhe në jetën publike greke, 85-vjeçari Aleksandros Likurezos është mjaft aktiv në profesionin e tij dhe klientët i ka kryesisht nga VIP-at e vendit. (marrë nga Tv Klan)

Bashkëshortët Fejzollari në "News 24": Duam të dimë se çfarë ndodhi

# Lindi binjakë në vitin 1982, nëna: Më thanë vdiqën, si pashë më kurrë

## "Nuk na jepet asnjë e dhënë, as akti i lindjes dhe as akti i vdekjes"

TIRANË

Në emisionin "Me Zemër të Hapur" në "News 24", ditën e djeshme u rrëfyer dy bashkëshortët, të cilët janë bërë prindër për herë të parë në vitin 1982. Klarita Fejzollari u bë nënë në moshë fare të re, por fati deshi që ajo të mos t'i kishte pranë dy binjakët që erdhën në jetë në datën 30.07.1982. Gruaja u shpreh se fëmijët lindën në parametra normale dhe se shtatzënia ka qenë normale pa probleme. Por pas lindjes, një ditë më pas gruaja dhe fëmijët u transferuan në repartin e Prematurës. Këtu nis dhimbja e nënës, e cila rrëfen se në këtë pavion ajo nuk u lejua t'i shihnte fëmijët e saj, madje gruaja tha se detyrohej t'i shihnte në fshehtësi duke u ndihmuar nga mamitë e turnit. Pas dy javësh qëndrimi në prematuro, nëna e re u njoftua se njëri nga binjakët ndërroi jetë. Gruaja rrëfroi se i thanë burrit të saj të bënte procedurat e varrimit. Por bashkëshorti e mohoi të ketë varrosur trupin e fëmijës së tij. Çifti sërisht u përball me humbje, pasi një javë më pas u njoftua që edhe fëmija tjetër kish të ndërroi jetë. Gruaja dhe bashkëshorti u larguan dhe morën me vete dhimbjen e madhe të humbjes së fëmijëve të tyre të parë. Jeta për ta vazhdoi dhe Zoti i gëzoi me dy fëmijë të tjerë. Por edhe pse koha ka kaluar, prindërit ende kanë shumë pikëpyetje lidhur me

### KËRKESA

Nëpërmjet një kërkese zyrtare që ata kanë bërë në Spitalin Obstetrik Gjinekologjik të Korçës rezultoi se fëmijët kanë lindur normalë e më pas janë transferuar në Prematurë. Më pas qytetarëve nuk u jepet asnjë e dhënë, as akti i lindjes dhe as akti i vdekjes. Bashkëshortët i janë drejtuar pavionit të Prematurës, por nga burime zyrtare ata janë njoftuar se gruaja dhe fëmijët nuk rezultojnë të regjistruar në vitin 1982 në këtë pavion.

ngjarjen. Plaga e humbjes së fëmijëve për ta nuk do të mbijetë kurrë. Po e vetmja gjë që

kërkojnë është të dinë se çfarë ka ndodhur realisht. Nëpërmjet një kërkese zyrtare që ata

kanë bërë në Spitalin Obstetrik Gjinekologjik të Korçës rezultoi se fëmijët kanë lindur normalë e më pas janë transferuar në Prematurë. Më pas qytetarëve nuk ju jepet asnjë e dhënë as akti i lindjes dhe as akti i vdekjes. Bashkëshortët i janë drejtuar pavionit të Prematurës, por nga burime zyrtare ata janë njoftuar se gruaja dhe fëmijët nuk rezultojnë të regjistruar në vitin 1982 në këtë pavion.

## Humbën mes malesh, policia gjen pas 20 orë kërkimesh dy turistët belgë

**VLORE** - Pas 20 orë kërkimesh janë gjetur dy turistët belgë, të cilët kishin humbur pa gjurmë, që prej mbrëmjes të së enjtes djeshme mes Llogorasë dhe Dhërmiut. Bëhet fjalë për Sem Besem 27 vjeç dhe Valeria Luk 27 vjeçe. Sipas policisë, lokalizimi i tyre ka qenë tepër i vështirë, pasi kushtet e këtij terreni janë tepër të thepisura dhe të thyera duke vështirësuar kështu komunikimin dhe gjetjen e tyre. Në kërkimet e tyre ishin të angazhuar forcat e policisë së Vlorës dhe DELTAS. Ndërkohë, sipas prefektit të Vlorës, turistët kishin ndërruar kamping në

zonën malore. "Më datë 18.04.2019, rreth orës 15:30, dy turistë të huaj belgë (çift) kanë telefonuar sallën operative Vlorë dhe kanë kërkuar ndihmë se kishin humbur në një zonë të thellë malore të Himarës. Menjëherë pas marrjes së informacionit, shërbimet e policisë Himarë kanë organizuar punën kërkimore për gjetjen e këtyre dy shtetasve duke u shpërndarë në terren rreth 15 forca policie. Lokalizimi i tyre ka qenë tepër i vështirë pasi kushtet e këtij terreni janë tepër të thepisura dhe të thyera duke vështirësuar kështu komunikimin dhe gjetjen e tyre. Pas 20 orë

kërkimesh intensive në këtë zonë shkëmbore është bërë e mundur gjetja e tyre gati në majë të një mali midis fshatrave Vranisht dhe Iljaz të Himarës. Ata kishin qenë duke ecur në këmbë me qëllim eksplorimin e turizmit malor të këtyre zonave. Për shkak të terrenit të vështirë kishin ngatërruar rrugën e kthimit dhe për këtë kërkuan ndihmën e Policisë. Teksojmë se turistët janë në gjendje të mirë shëndetësore dhe po bëhet transporti i tyre pranë hotelit bazë në të cilin ata po qëndrojnë. Turistët kanë falënderuar policinë për ndihmën e dhënë"-njoftoi policia.



GRUAJA LIND BINJAKE NE 1982, I THANE SE HUMBEN J

### SHKURTE

#### Shpërthim me tritol në një oficinë

**FUSHË-KRUJË** - Një shpërthim tritolit ka tronditur Fushë-Krujë në orët e para të mëngjesit të djeshëm. Mësohet se shpërthimi i eksplozivit ka ndodhur në një oficinë në Kameras, e cila është në pronësi të shtetasit B.D. 36 vjeç. Si pasojë e shpërthimit raportohet të ketë vetëm dëme materiale. Menjëherë pas sinjalizimit, blutë kanë shkuar në vendngjarje dhe kanë nisur punën për identifikimin dhe kapjen e autorëve.

#### U vetëplagos me armën e partneres police, vdes

**TIRANË** - Mesditën e djeshme ka ndërruar jetë në spital 50-vjeçari Bernard Uka, i cili u vetëplagos mesditën e djeshme në banesën e tij përballë godinës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Mësohet se arma, me të cilën Uka qëlloi veten i përkiste partneres së tij, efektive policie. Ndërkohë, dyshohet që ngjarja të jetë aksidentale. Policia po punon për sqarimin e mëtejshëm të rrethanave të ngjarjes.

## Ekstradohen nga Greqia drejt Shqipërisë 2 të shumëkërkuar për drogë dhe mashtrim

**TIRANË** - Janë ekstraduar nga Greqia drejt Shqipërisë shtetasit E.Sh. 31 vjeç dhe shtetasja F.X.H. 69 vjeçe. Shtetasit E.Sh. në kërkim ndërkombëtar për trafik droge është dënuar nga gjykata e Pogradecit me 5 vite e 4 muaj burg. Më datë 04.02.2014 ky shtetas, në bashkëpunim me persona të tjerë kanë transportuar një sasi lëndë narkotike nga Tepelena, me qëllim shitje në qytetet Korçë dhe Pogradec. Shtetasit E.Sh. është arrestuar më datë 21.06.2018 nga autoritetet policore të Greqi, me qëllim ekstradimit drejt vendit tonë. Gjithashtu, është ekstraduar dhe shtetasja F.X.H. 69 vjeçe nga ana tjetër e shpallur në kërkim ndërkombëtar për "Mashtrim" dhe dënuar me 6 vjet e 8 muaj burg në 2015 për të njëjtën akuzë. Më datë 21.12.2012 në Tiranë, shtetasja në fjalë nëpërmjet mashtrimit ka shitur banesën e një shtetaseje të një personi i tretë. F. X.H. është arrestuar më datë 02.11.2018 nga autoritetet policore të Greqi, me qëllim ekstradimit drejt vendit tonë"- njoftoi policia.

**Shoqëria perbarimorë JUSTITIA**  
Shoqëria perbarimorë JUSTITIA sh.p.k. shpall ankandin, faza e trete, për shitjen e pasurisë së paluajtshme për të cilën ka vënë hipoteke BKT BANK, me këto të dhëna:  
Pasuria "KARÉ" nr. 175, Zona Kadastrale 3339, me sipërfaqe 7780 m<sup>2</sup> faqe 190 vol.5, e ndodhur në Vrin Durrës, në pronësi të z.Adrjan Sefer Kapllani diti.08.03.1969, zj. Merita Myzater Kapllani diti.24.06.1970  
Në vlerën 7.308.000 (shtatë milion e treqind e tetë mijë) Lekë.  
Pasuria Apartamenti me sip. 120m<sup>2</sup> nr.pas.41/150+1-1.zk.8518 vol.116 fq.54 me adresë:Plazh/13 Durrës në pronësi të z.Adrjan Sefer Kapllani diti.08.03.1969.  
Në vlerën 3.390.569 (tre milion e treqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë.  
Ankandi zhvillohet në datën 20.05.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbaruesit gjyqësor me adresë Bulevardi"Bağram Curri", Pall. 21,Shk.3, Ap. 18, Tiranë.

**Shoqëria perbarimorë JUSTITIA**  
Shoqëria perbarimorë JUSTITIA shpall ankandin, faza e parë, për shitjen e pasurisë së paluajtshme për të cilën ka vënë hipoteke ABI BANK, me këto të dhëna:  
"Ara", me sipërfaqe 5.130 m<sup>2</sup>, me adresë në Piraj, Lezhë, në Zonën Kadastrale Nr. 2964, me Nr. Pasurie 2019/Vol. 1, fq. 127, në pronësi të znj. Alma Luçi Marku.  
Në vlerën 2.480.000 (dy milion e katërqind e tetëdhjetë mijë) Lekë.  
"Njësi", me sipërfaqe 191 m<sup>2</sup>, me adresë në Lagjen "Besëlidhja", Lezhë, në Regjistrin hipotekor Nr. 578, datë 28.10.2016, me Zonën Kadastrale Nr. 8632, me Nr. Pasurie 4/400-N11, në pronësi të Shoqërisë ENCO GROUP sh.p.k.  
Në vlerën 107.200 EUR (njëqind e shtatë mijë e dyqind) EUR.  
Ankandi zhvillohet në datën 03.05.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbaruesit gjyqësor me adresë Bulevardi"Bağram Curri", Pall. 21,Shk.3, Ap. 18, Tiranë.

**NJOFTIM ANKANDI**  
1. Shoqëria e Përbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k njofton Shpalljen e Ankandit të II (Dytë), për shitjen e pasurisë së paluajtshme: Njësi, me sip. 142 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale: 2640, Numri i Pasurisë: 490396+3-N2, Vol. 52, Faqe 239, ndodhur në Fshëz Daj, Tiranë, në pronësi të: Shoqërisë "AGU" sh.p.k identifikuar me NIF: J7172004M. Ankandi i pasurisë fillon me grimin fillestar në vlerën 4.962.048 (katër milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e dyzet e tetë) LEKË.  
Ankandi do të zhvillohet më datë 23.04.2019, ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë së Përbarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k, në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.teléfono 042320227, email: elvith@hotmail.com.

Ja lidhja e vjetër mes Admir Muratajt e Çalës. Policia, kontrolle në fshatrat e Fushë-Krujës

# Supergrabitja në aeroportin e Rinasit, dyshohen si bashkëpunëtorë Klement Çala dhe Aleks Pepa

Hetimet për ngjarjen e 9 prillit, i dyshuar edhe një ish-efektiv policie



TIRANË

Pak ditë pas supergrabitjes së ndodhur në aeroportin e Rinasit, dyshohet se bashkëpunëtorët e Admir Muratajt, që mbeti i vrarë me plumb në kokë janë persona, me të cilët ai ka njohje të hershme dhe ka kryer disa grabitje me ta. Mjeshtrë i grabitjeve të bankave, kështu është cilësuar Klement Çala, 31-vjeçar, që dyshohet të ketë bashkëpunuar me Admir Muratajn edhe në grabitjen e 9 prillit. Emri i tij ka dalë gjatë hetimeve për ngjarjen që mori vëmendjen e të gjithëve, jo vetëm brenda kufijve. Vrasja dhe identifikimi i Muratajt bëri që policia të verifikojë emrat pranë tij dhe bashkëpunëtorët nga e kaluara. Policia nisi vëzhgimin dhe dyshon se ish-policia me iniciale M.H., Aleks Pepa dhe Klement Çala kanë bashkëpunuar me Muratajn edhe në grabitjen e fundit të miliona eurove nga një avion që do të udhëtonte drejt Austrisë. Por, arrestimi i tyre kërkon prova, të cilat grupi hetimor po i verifikon nëse do i çojnë tek personat e dyshuar. Ndërkaq, ditën e djeshme policia ka nisë një aksion në fshatrat e Fushë-Krujës, në kërkim të autorëve të grabitjes në aeroportin e Rinasit. Blutë kanë marrë indicie se autorët e grabitjes mund të fshihen në këto fshatra.



Admir Murataj dhe të dyshuarit si bashkëpunëtorë në grabitjen e Rinasit

**I DYSHUARI ALEKS PEPA**  
 Prokuroria ka bërë pjesë të këtij hetimi edhe grabitjen e 30 qershorit 2016, ku në pistën e Rinasit u grabitën 1 milion euro. Për këtë ngjarje u shpall në kërkim Aleks Pepa. 44-vjeçari nga Elbasani, së bashku me dy persona të tjerë, thyen sigurinë në Rinas thuajse me të njëjtën mënyrë që u përdor në grabitjen e 9 prillit. Por, provat e policisë që këto tri grupe të kenë bashkëpunuar dhe të jenë bërë një në grabitjen e fundit janë të pakta, megjithatë është njëra pistë që po ndiqet.

**MINISTRI LLESHAJ**  
 Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj ka zhvilluar dje një takim urgjent në ambientet e ministrisë me varësit e tij. Mësohet se në këtë takim, në fokus të të cilit ishte siguria dhe rendi në vendin tonë, mori pjesë dhe drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu; drejtori i Policisë Kriminale, Tonin Vocaj dhe disa drejtorë qarqesh. Burime për "GSH" bënë me dije se në takimin e djeshëm është diskutuar për grabitjen e Rinasit, si dhe analizimin e informacioneve të mbërritura nga partnerët për disa grupe kriminale.

## "Shfaqej duke hyrë në vilën e Admir Muratajt"

### Grabitja e blindit me 3.2 mln dollarë në Rinas, pamjet filmike "tradhtuan" Klement Çalën

**TIRANË** - Pamjet filmike të kamerave të sigurisë të instaluar në vilën luksoze të Admir Muratajt në Fushë-Pezë "tradhtuan" të dyshuarin e radhës si bashkautor në grabitjen e blindit në Qafë-Kashar më 9 shkurt. Bashkëpunimi i mëhershëm i tyre ka qenë në Greqi në vitin 2013, ku bashkë me Muratajn grabitën 1 milion euro në Bankën Kombëtare Greke, në qendër të qytetit të Larisës dhe është shpallur në kërkim që prej vitit 2013. I arratisur nga burgu i Trikalas në 22 mars 2013, si pjesëtar i grupit prej 11 personash të Marjan Kolës, Klement Çala u shpall menjëherë në kërkim nga policia greke. Rreth orës 8:40 në mëngjesin e së enjtes të 16 majit 2013, Çala së bashku me një person tjetër, të dhënat e të cilit ende nuk dihen, kanë hyrë fillimisht si klientë në bankë dhe më pas nën kërcënimin e armëve të tipit 'Kallashnikov' kanë grabitur rreth 1 milion euro. Ata kanë ikur nga vendi i ngjarjes përmes një driftojeje. Pak orë pas grabitjes, është gjetur një makinë e djegur në zonën e Larisës, e cila ishte raportuar si e vjedhur që prej 17 tetorit të 2011-ës në Athinë. Skenari duket i ngjashëm me grabitjet e transfertave bankare Tiranë-Rinas. Çala ishte identifikuar si autor i



forta dhe brenda pak ditësh do të bëhet një veprim i tillë procedural. I çuditshëm është fakti sesi Klement Çala ka

plagosjes së një efektivit të policisë greke dhe vrasjes së një qytetareje të pafajshme gjatë shkëmbimit të zjarrit me trupat e policisë. Policia greke kishte gjetur gjurmë ADN-je të Klement Çalës në furgonin e bardhë të vjedhur në Korinth, me të cilin të arratisurit nga burgu i Trikalasë kishin tentuar t'i shpëtonin arrestimit. Më 29 qershor 2015, Klement Çala, i shpallur në kërkim ndërkombëtar është arrestuar nga policia e

Vlorës. Policia lokale finalizoi me sukses operacionin "Streha e fundit", ku u bë i mundur arrestimi i 29-vjeçarit Çala banues në Elbasan, si edhe i një 31-vjeçari tjetër të shpallur në kërkim. Në momentin e ndalimit, Çala po lëvizte në lagjen "24 maji" me automjetin e tij tip "Benz", me targë AA 447 KO. Ai ruajti gjaktohësinë dhe tentoi t'i shmangej arrestimit duke u paraqitur me emrin Semir Koca. Për këtë identitet, ai dispononte edhe një

mundur të lëvizte lirshëm përgjatë gjithë kësaj kohe, kur ndaj tij ekzistonte një urdhër arresti në mungesë. Ai po gjykohej në Gjykatën e Krimeve të Rënda për akuzën e vrasjes së punonjësit të policisë, mbetur në tentativë, gjatë arratisjes nga burgu i Trikalasë në Greqi bashkë me Admir Muratajn, Ilir Kupën e disa të dënuar të tjerë. Ndërkohë, deri më tani për grabitjen e bankës janë vënë në pranga 8 persona, ndërsa Admir Murataj vazhdon ende të jetë në arrati. **kl.la.**

edhe akuzat e reja pas arrestimit nga policia e Vlorës. Nuk dihen ende rrethanat, por pas vetëm tre muajsh Çala është liruar nga burgu ndërsa për të ishte lëshuar një urdhër ndërkombëtar arresti. Nuk dihet se si mundi Klement Çala të dilte nga burgu, duke pasur një numër kaq të madh akuzash mbi shpinë. Më 16 dhjetor 2016, Prokuroria e Krimeve të Rënda ka mbyllur dosjen hetimore dhe ka dërguar për gjykim një nga të arratisurit

nga burgu i Trikalas në Greqi në mars të vitit 2013, si pjesë e grupit të Marjan Kolës. Shtetasi Klement Çala akuzohet për disa vepra penale, si ajo e "vrasjes me dashje të punonjësit të policisë", mbetur në tentativë, dy herë, si edhe për veprat penale të krijimit të organizatës kriminale, largimit nga burgu dhe armëmbajtje pa leje". Akuzat e fundit për Klement Çalën dhe e shkuara e tij kriminale e bëjnë atë një person me rrezikshmëri të lartë. Prokuroria ka bërë pjesë të këtij hetimi edhe grabitjen e 30 qershorit 2016, ku në pistën e Rinasit u grabitën 1 milion euro. Për këtë ngjarje u shpall në kërkim Aleks Pepa. 44-vjeçari nga Elbasani, së bashku me dy persona të tjerë, thyen sigurinë në Rinas thuajse me të njëjtën mënyrë që u përdor në grabitjen e 9 prillit. Por, provat e policisë që këto tri grupe të kenë bashkëpunuar dhe të jenë bërë një në grabitjen e fundit janë të pakta, megjithatë është njëra pistë që po ndiqet. Ende policia nuk ka rënë në gjurmët e këtyre personave, pasi janë mjaft të kujdesshëm dhe nuk lënë gjurmë për lëvizjet që kryejnë. Ndërsa, ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj, paraditen e djeshme ka zhvilluar një takim me krerët e policisë. Pjesë e diskutimeve ka qenë edhe grabitja e ndodhur në pistën e Rinasit. Të enjten në parlament, Lleshaj tha se kjo ngjarje do të zbardhej shumë shpejt.

Segmenti "Pallati me Shigjeta"-rrethrotullimi "Shqiponja", vlera në lekë për çdo pronar

Publikohet lista me 146 pronarët që do të kompensohen në segmentin "Pallati me Shigjeta"-rrethrotullimi "Shqiponja". Shuma në total është 10 milionë euro, ose 1 miliardë e 224 milionë lekë. "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë me gjerësitë dhe përfituesve, sipërfaqen e kompensimit, qoftë ajo tokë arë, truall apo shtëpi dhe vlerën për çdo përfitues. Vendi për kompensimin e pronarëve hyn në fuqi sot dhe priten vetëm procedurat rutinë bankare për kalimin e parave në favor të përfituesve.

**VENDIMI**

Këshilli i Ministrave ka miratuar në mbledhjen e së enjtes vendimin për shpronësimin, për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga

# Publikohet lista/ 146 pronarët që marrin kompensimin tek Unaza e Re

## Si do të ndahen 1 miliard e 224 milionë lekë

realizimi i projektit "Rehabilitimi i segmentit rrugor "Pallati me Shigjeta"-rrethrotullimi "Shqiponja". Vendi është botuar dje në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi menjëherë. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen do të kompensohen në vlerë të

plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, për pasuritë e llojit "truall", "tokë arë" dhe "ndërtesë", me një vlerë të përgjithshme prej 1 miliard e 224 milionë e 874 mijë lekë. Vlera e përgjithshme e shpronësimit do të përballohet nga llogaria "Fondi i shpronësimeve" në Bankën e Shqipërisë, ndër-sa shpenzimet procedurale

në vlerën 50 000 lekë të përballohen nga fondet e Autoritetit Rrugor Shqiptar.

**KOMPENSIMI**

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar. Vendi për kompensimin e pasurive të shpronësuar, në favor të shtetit. Agjencia Shtetërore e Kadastrës brenda 30 ditëve

nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar do të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuar, në favor të shtetit. Agjencia Shtetërore e Ka-

dastrës do të pezullojë të gjitha transakcionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për regjistrimin e aktit pa tarifa regjistrimi.

No.	PRONAR			TE DHËNAT			VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT E PASURISË														VLERA	SHËNIME	
	Emri	Adresa	Mbiemri	ZK	No.	Lloji	Shpronësim tokë "arë"			Shpronësim tokë "truall"			Ndërtesë banimi (shëpi)			Ndërtesë jo banimi			Ndërtesë totale				
							Sip. (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)	Sip. (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera (lekë)	Sip. Ndërt. (m2)	Çmimi mes. (m2)	Vlera (lekë)	Sip. Nd. konf. nga ZVRPP (m2)	Vlera sipas Provencit (lekë)	Sip. Nd. konf. nga ZVRPP (m2)		Vlera sipas Provencit (lekë)			
1	Bullhëm Illa Agim Albert Anxori Ester Genci Peshan Lilaz	Rr. Shkëlzen Nisio Lustri Spino Gulo Kondolepa Dorri Shkëlzen Zano Lefter	Shari	8310	12/19	Truall	3934.66			1283	31219	40053977									40,053,977	Konf. ZVRPP	
2	Reza	Zhani	Gjoni	8310	12/121.34	Ndërtesë	73.6						73.6	7000	512000					73.6	3,152,600	Konf. ZVRPP, Konfirmim në favor të Raifitman Bank.	
3	Reza	Zhani	Gjoni	8310	12/203	Truall	200			200	31219	6243800									6,243,800	Konf. ZVRPP, Konfirmim në favor të Raifitman Bank.	
4	Përpam Merita Emirita	Shaban Abdull Shef	Cananeri Gedonia	8310	12/21	Truall, Ndërtesë	922			406	31219	12674914			794	5,618,132	794				18,293,046	Konf. ZVRPP	
5	Agim Engjell Gjerd Shef	Alaka Hera Ali Abdulla	Spino Bekteri Brenari Shkëlzen	8310	12/22	Truall	1300			49	31219	1529731									1,529,731	Konf. ZVRPP	
6	Anton		Gjoni	8310	12/115	Truall	1337			25	31219	780475									780,475	Konf. ZVRPP, Konfirmim në favor të Prof. Andri Bank.	
7	Nanaha	Nasif	Dervishi	8310	12/153	Truall, Ndërtesë	32.6			32.6	31219	101779.4			25.7	769,337					1,287,074	Konf. ZVRPP	
8	Sefedus		Biri	8310	12/116	Truall	850			78	31219	2435082									2,435,082	Konf. ZVRPP	
9	Alma	Qasim	Shaku	8310	10/169	Truall, Ndërtesë	1627			379	31219	1183200					40	21,689,043	40		33,521,944	Konf. ZVRPP, Konfirmim në shpronësimin E si kushtesë.	
10	Coloman H shpik Vekol shpik			8310	12/298	Truall	6000			60	31219	1873140									1,873,140	Konf. ZVRPP	
11	Beoni	Adam	Doçi	8210	7/521	Truall, Ndërtesë	254			254	38614	9807956	167.52	65000	10888800	48	1,370,882.00			215.52	22,067,636	Konf. ZVRPP	
12	Beoni	Adam	Doçi	8210	7/522	Truall, Ndërtesë	230.1			24.7	38614	953765.8	151.48	65000	9846200	70.7	2,019,197.00			222.18	12,819,162	Konf. ZVRPP	
13	Perit	Nasir	Schmani	8210	7/418	Truall	174			174	38614	6718836									6,718,836	Konf. ZVRPP	
14	Enri	Nasir	Schmani	8210	7/419	Truall	174			174	38614	6718836									6,718,836	Konf. ZVRPP	
15	Hysen Pëllumb	Zyfi Zyfi	Sasçi Sasçi	8210	7/303	Truall	805.6			246	38614	9499044									9,499,044	Konf. ZVRPP	
16	Alban Gjerdan	Paqë Paqë	Kali Kali	8210	7/498	Truall	616.3			87	38614	3359418									3,359,418	Konf. ZVRPP	
17	Gjerdan	Paqë	Kali	8210	7/474	Truall, Ndërtesë	530.2			241	38614	9300974					230	3,731,287			13,037,261	Konf. ZVRPP	
18	Dasha	Ala	Sako	8210	7/476	Truall	378			149	38614	5753486									5,753,486	Konf. ZVRPP, Gjurmë e shpronësimit të tokës sipas planimetrisë së shpronësimit, për të cilën nuk janë kushtet në shpronësimin në tabelë, pasi grupet në shpronësimin nuk i janë kushtuar miratimit.	
19	Ejten	Dasha	Sako	8210	7/475	Truall	1422			411	38614	15870354									15,870,354	Konf. ZVRPP	
20	Uke	Idris	Carloq	8210	7/46	Truall	300			300	38614	11584200									11,584,200	Konf. ZVRPP	
21	Albert	Lilo		3866	215/136	Truall, Ndërtesë	214.3			214.3	4242	909600.0	225	53300	1207500						225	1,294,560	Konf. ZVRPP, Baza Hipotekare, favor të Alpha Bank - Shtetërore Komerciale.
22	Bashkëpunuesit sipas certifikates se pronetise			3866	301/217	Anë	11148	2889	448	1294272											1,294,272	Konf. ZVRPP, Konfirmim në favor të shqiptare Romane.	
23	Beno Kujda	Kamrion Kamrion	Rovca Rovca	3866	305/127	Anë	1206	102	448	45696											45,696	Konf. ZVRPP	
24	Kojtim		Hylka	3866	305/76	Anë	2362	628	448	281344											281,344	Konf. ZVRPP	
25	Shqipri	Sulo	Sulaj	3866	305/70	Anë	562	491	448	219968											219,968	Konf. ZVRPP	
26	Jashar	Bajram	Poci	3866	306/168	Anë	1025	1025	448	459200											459,200	Konf. ZVRPP	
27	Muafja	Novruz	Tapi	3866	306/352	Truall	270			270	4242	1145340									1,145,340	Konf. ZVRPP, Hipotekë në favor të BKT, Gjurmë e shpronësimit të tokës sipas planimetrisë së shpronësimit, për të cilën nuk janë kushtet në shpronësimin në tabelë, pasi grupet në shpronësimin nuk i janë kushtuar miratimit.	
28	Dritan		Nisio	3866	306/353	Anë	130	130	448	58260											58,260	Konf. ZVRPP	
29	Engjellshpe Lindi	Zemel Zemel	Peci Biri	3866	306/166	Anë	4383	1232	448	551936											551,936	Konf. ZVRPP	
30	Hamdi	Orman	Bishaku	3866	306/208	Anë	2830	351	448	157248											157,248	Konf. ZVRPP	
31	Agnes Vioera Dhurat Robert Larje Rudi Orizana Agnes Emet Sami	Quka Sarali Subanovca Cabej Eleri Subanovca Subanovca Subanovca Subanovca		3866	306/209	Truall	5200			1280	4242	5,429,760									5,429,760	Konf. ZVRPP	
32	Dritan	Fiko	Llami	3866	313/43	Anë	725	364	448	163072											163,072	Konf. ZVRPP	
33	Freid	Bajram	Muafja	3866	315/123	Anë	200	12	448	876											5,376	Konf. ZVRPP	



34	Shelkën	Hyrësim	Safa	8210	7/484	Traul	1737				1120	38614	43,347,680			43,347,680.00	Konf. ZVRPP					
35	Ashë Hyzen Pellumb	Herësim	Safa (Lagomi) Saraci	8210	7/493	Traul	8038				385	38614	14,866,390			14,866,390.00	Konf. ZVRPP					
36	Ashë Hyzen Pellumb		(Lagomi) Saraci Saraci	8210	7/500	Traul	1946				1249	38614	48,228,886			48,228,886.00	Konf. ZVRPP					
37	Ashë Hyzen Pellumb	Zyhabë Zyhabë Zyhabë	Lagomi Saraci Saraci	8210	7/413	Traul	400				143	38614	5,321,802			5,321,802.00	Konf. ZVRPP					
38	Bashkëpunuesit		Shijaku Tafaj Keremendi Bratju Hidhalë Ahmeti Aliu Bustari	8210	7/258	Traul	60				60	38614	2,316,840			2,316,840.00	Konf. ZVRPP					
39	Ramazani	Nëziri	Selmani	8210	7/415	Traul	19				19	38614	733,666			733,666.00	Konf. ZVRPP					
40	Bashkëpunuesit		Hidhalë Shijaku Tafaj Bratju Keremendi Ahmeti Bustari Aliu	8210	7/465	Traul	13,996.6				469	38614	18,099,966			18,099,966.00	Konf. ZVRPP					
41	Kuçtim	Nëziri	Selmani	8210	7/417	Traul	347				227	38614	8,765,378			8,765,378.00	Konf. ZVRPP					
42	Yli	Nëziri	Selmani	8210	7/432.N1	Ndërtesë	42.2							42.2	1,320,537	1,320,537.46	Konf. ZVRPP					
43	Yli	Nëziri	Selmani	8210	7/432	Traul	355.6				125	38614	4,826,750			4,826,750.00	Konf. ZVRPP					
44	Ashë Hyzen Pellumb	Zyhabë	Lagomi Saraci Saraci	8210	7/519	Traul	721				203	38614	7,838,642			7,838,642.00	Konf. ZVRPP					
45	Shqipëria Rending Shqip			8210	7/523	Traul Ndërtesë	99.5				91	38614	5,515,874	81.6	6800	5304000	113.4	6,709,673.46	195	15,527,747.46	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të Foratit Bosa	
46	Shqipëria Rending Shqip			8210	7/524	Ndërtesë	126.3											193	114,9804.54	193	114,9804.54	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të Foratit Bosa
47	Soc Uke Elera Bosniti	Syle Idriz Idriz Idriz	Celloshë Celloshë Cakraj Celloshë	8210	7/44	Traul	300				100.7	38614	3,888,430			3,888,430.00	Konf. ZVRPP					
48	Haili	Mari	Mari	8210	7/45	Traul	287.6				12	38614	463,568			463,568.00	Konf. ZVRPP					
49	Gjolek	Idham	Mala	8866	315/304	Traul	780				156	4242	661,752.00			661,752.00	Konf. ZVRPP					
50	Nohur	Frang	Martini	3866	315/662	Traul Ndërtesë	303				303	4242	1,285,326			1,285,326.00	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të Alpha Bank					
51	Nohur	Frang	Martini	3866	315/663	Traul Ndërtesë	813				141	4242	598,122			598,122.00	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të Alpha Bank					
52	Frang	Dhale	Martini	3866	315/654	Traul Ndërtesë	244.7				20	4242	84,840	183	53500	9790500	398.5	16,664,887.24	392.5	17,263,009.24	Konf. ZVRPP	
53	Frang	Dhale	Martini	3866	315/653	Traul	134				134	4242	84,840			84,840.00	Konf. ZVRPP					
54	Nëziri	Ismail	Hyndeli	3866	315/86	Arc	2000	660	448	295680						295,680.00	Konf. ZVRPP					
55	Nëziri	Ismail	Hyndeli	3866	315/89	Arc	500	121	448	54208						54,208.00	Konf. ZVRPP					
56	Flori	Aseni	Protosant	3866	315/546	Traul Ndërtesë	474				292	4242	1,238,664	227.2	53300	12153200	453.9	13,393,664.00	Konf. ZVRPP, Gjenera e depozitimit për objektin e kombinar, për të cilën nuk janë bërë veçimet në shtetë, pasi propozit të depozitimit nuk i janë sjatur matës.			
57	Shërkajim	Saraci	Saraci	3866	305/309	Traul	326.2				23	4242	97,566			97,566.00	Konf. ZVRPP					
58	Gani	Rehëp	Brhanaj	3866	301/217.N4-4	Ndërtesë	94.6				215	4242	912,030	131.8	53300	7051300	80.7	2,853,782	212.5	9,905,082.2	Konf. ZVRPP	
59	Beviri	Qemil	Brhanaj	3866	305/293	Traul Ndërtesë	300.1				424	4242	912,030	135.5	53300	8479750	108	3,632,379	266.5	13,043,199.34	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të Alpha Bank	
60	Sazan	Feriz	Almullih	3866	300/119	Arc	270	96	448	43908						43,908.00	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të Alpha Bank					
61	Adnan	Selmani	Nume	3866	301/166	Arc	1270	457	448	204736						204,736.00	Konf. ZVRPP					
62	Bontpano		Di Francesco	3866	315/208	Arc	700	395	448	176960						176,960.00	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të Alpha Bank					
63	Marija	Kuçtim	Mallen	3866	315/630	Arc	1000	138	448	61824						61,824.00	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të Alpha Bank					
64	Eton	Shaban	Shehu	3866	215/200.N4	Ndërtesë	69									156.5	4,657,205	156.5	4,657,205.00	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të Alpha Bank		
65	Artan	Imezi	Caushi	3866	306/257	Traul Ndërtesë	547				547	4242	2,320,374			916.1	27,134,529.3	916.1	29,454,903.30	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të Alpha Bank		
66	Abedin	Kacimi	Dyrmishi	3866	315/609/2	Arc, Traull Ndërtesë	110	14	448	6272	87	4242	569,054	214.2	53300	11497700	87	2,279,603	301.2	14,114,629.34	Konf. ZVRPP	
67	Isa	Sherif	Diouji	3866	315/609/3	Arc, Traull Ndërtesë	58	11	448	4928	47	4242	199,574	130.8	53300	6997900	47	1,214,296	177.8	8,416,398.03	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të Alpha Bank	
68	Isa	Sherif	Diouji	3866	315/609/4	Traul Ndërtesë	52				28	4242	118,776	83.4	53300	4461900	40	1,033,434	123.4	5,614,109.50	Konf. ZVRPP	
69	Nismer	Zogju	Saraci	3866	305/329	Arc+Traull	400	81.7	448	36601.6	147	4242	623,374				147	660,175.60	147	660,175.60	Konf. ZVRPP	
70	Albert Hysni Burr Sotaku	Hajredin Hamdi Hamdi	Vaher Vaher Cipi Cipi	3866	305/321	Traul Ndërtesë	310.1				305	4242	1,293,810	260.2	53300	13920700	370.8	10,610,224.18	631	25,824,734.18	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të ProCredit Bank	
71	Albert Hysni Burr Sotaku	Hajredin Hamdi Hamdi	Vaher Vaher Cipi Cipi	3866	305/322	Traul Ndërtesë	328				886	53300	47401000	1190.6	54,068,320	2076.6	81,469,375.00	2076.6	81,469,375.00	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të ProCredit Bank		
72	Flajstev	Mahmem	Shima	2679	440/278	Traul Ndërtesë	205				103	4242	436,926	227.6	53300	12176600	103	4,361,526	227.6	4,361,526.00	Konf. ZVRPP	
73	Emin	Ram	Dokoshi	2679	440/201	Traul Ndërtesë	761				761	4242	3,228,162			154	52,379,709	154	55,607,871.00	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të Banka Investime		
74	Latif	Ramiz	Perkoda	2679	440/416	Traul Ndërtesë	481				120	4242	509,040			62.6	1,799,271	62.6	2,308,311.00	Konf. ZVRPP		
75	Befti	Rasim	Peposhi	2679	440/53	Traul Ndërtesë	1730				1248	4242	5,294,016			465	6,807,388	465	12,301,404.42	Konf. ZVRPP		
76	Fadil	Alabi	Dunaku	3866	315/572	Traul	4000				543	4242	2,303,466				42	2,303,466.00	42	2,303,466.00	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të NBE	
77	Fadil	Alabi	Dunaku	3866	315/576	Traul Ndërtesë	1000				388	4242	1,645,896				42	5,956,069.4	42	5,956,069.4	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të Alpha Bank	
78	Edmond	Sen	Mema	3866	315/773.N3 315/173	Ndërtesë Arc	500	360	448	161280						316.4	7,607,337	316.4	7,608,617.00	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të Alpha Bank		
79	Konstandin	Thomas	Tecoforti	3866	315/176	Arc	180	180	448	80640							0	80,640.00	0	80,640.00	Konf. ZVRPP	
80	Hasbi	Zemel	Lidj	3866	315/80	Arc, Traull Ndërtesë	200	37	448	16576	163	4242	691,446	242.3	53300	12963050	242.3	13,671,072.00	242.3	13,671,072.00	Konf. ZVRPP	
81	Hasbi	Zemel	Lidj	3866	315/80	Arc	86	86	448	38328							0	38,328.00	0	38,328.00	Konf. ZVRPP	
82	Nasif	Ramadhan	Lekli	3866	315/592	Arc	104.3	104.3	448	46726.4							0	46,726.40	0	46,726.40	Konf. ZVRPP	
83	Nasif	Ramadhan	Lekli	3866	315/593	Traul Ndërtesë	376.7				376.7	4242	1,397,061	217.2	53300	11620200	217.2	13,218,161.40	217.2	13,218,161.40	Konf. ZVRPP	
84	Rajmond	Myftar	Hooshalli, (Shegji)	3866	306/210	Traul Arc Ndërtesë	500	109.5	448	49056	214.5	4242	909,909	286.2	53300	15311700	127.5	3,464,785	413.6	19,735,450.00	Konf. ZVRPP	
85	Ferit	Llana	Llana	3866	315/537	Traul Ndërtesë	238				203	4242	861,26	429	53300	2291300	252.4	8,849,945	481.4	32,662,571.32	Konf. ZVRPP	
86	Bashkim	Ramazan	Drita	3866	315/68	Arc, Traull Ndërtesë	375	37.4	448	16755.2	337.6	4242	1,432,099	400	53300	21400000	154	4,025,941	544	26,874,795.51	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të Alpha Bank	
87	Bashkëpunuesit Lagomi dhe te tj.			3866	215/200	Arc	7352.2	1406	448	629888							0	629,888.00	0	629,888.00	Konf. ZVRPP, kufizim në favor të Alpha Bank	
88	Bashkëpunuesit Lagomi dhe te tj.			3866	809/291	Traul	17860				880	4242	2,460,360				0	2,460,360.00	0	2,460,360.00	Konf. ZVRPP	
89	Mendi	Guri	Goda	3866	301/220	Arc	1700	84	448	37632							0	37,632.00	0	37,632.00	Konf. ZVRPP	
90	Skender		Doda	2679	440/298	Traul	500				113	4242	479,346				0	479,346.00	0	479,346.00	Konf. ZVRPP, Gjenera e depozitimit për objektin e kombinuar, për të cilën nuk janë bërë veçimet në shtetë, pasi propozit të depozitimit nuk i janë sjatur matës.	
91	Sabri	Rashid	Gjani	3866	315/580	Arc, Traull Ndërtesë	244	27.4	448	12275.2	216.6	4242	918,817	146.9	53300	7859150	131	4,149,745	277.9	12,939,987.10	Konf. ZVRPP	
92	Hasbi	Syti	Alcani	3866	315/645	Arc	300	58	448	25984							0	25,984.00	0	25,984.00	Konf. ZVRPP	
93	Qemal	Nevdet	Lazmi	2679	440																	



## INTERVISTA

Fatmira Nikolli

Shqipëri 1997. Një imazh video, rrëqethës e i vjetruar, i shfaqet çdo natë si një makth Julianit, duke e zgjuar prej gjumit. Pas gati njëzet vjetësh nga vrasja e gruas së tij, Angelinës, Juliani kthehet në Shqipëri i vendosur të hetojë mbi vdekjen e saj mes një deti regjistrimesh të pabesueshme, dosjesh policore e vizionesh të botës së përtejme. Ky është me një film, sinopsi i filmit "Zgjimi i Enver Simakut". I realizuar nga regjisori i ri, Marco Lledó, ai rrëfen hetimin e një gazetari (Julien Blaschke), gruaja e të cilit është vrarë para 20 vjetëve, i cili kthehet në Shqipëri për të hetuar për vdekjen e saj misterioze, në përpjekje për të kuptuar atë që ka ndodhur realisht. I përshkruar nga vetë kineasti si një përzjerje e realitetit dhe trillimit, ky "thriller", emocionues që zgjat 106 minuta do të shfaqet të martën 23 prill, ora 19:00 në kinema "Milenium" (Tiranë). Hyrja është e lirë dhe filmi shfaqet me titra në anglisht. Në shfaqjen e filmit do të jenë të pranishëm një pjesë e madhe e trupës shqiptare përveç të tjerëve, Tinka Kurti, Margarita Xhepa, Lulzim Gubelli, Viktor Zhusti, Ema Andrea, Laert Vasili, Piro Milkani, Julien Blaschke si dhe drejtori spanjoll i filmit Marco Lledó dhe ekipi i produksionit. Të pranishëm do të jenë gjithashtu, përfaqësues të jetës kulturore dhe kinematografike shqiptare, ambasadori i Spanjës në Shqipëri dhe stafi i tij, si dhe përfaqësues të trupit diplomatik në Tiranë. Vetë regjisori është shprehur se "gjëja e parë dhe më e habitshme është të mbërrish në një vend kaq të panjohur e të t'i hapin dyert tej e tej. Të gesh kaq shumë mbështetje e kaq shumë pasion edhe pse bëhet fjalë për një projekt të vogël si ky i yni. Ndonjëherë nuk jam në gjendje të dalloj nëse është Shqipëria apo Elsa Bakshhevani, producentja ime e asociuar dhe Anastasi Prodani, mbështetja tjetër e imja atje. Me këtë dua të them që nuk e di nëse përvoja do të kish qenë e njëjtë me persona të tjerë. Singerisht dyshoj. Por, është gjithashtu e vërtetë se ka një frymë të përgjithshme në Shqipëri, që ndryshe nga Spanja, bën që gjërat të ndodhin më shpejt. Në një mënyrë më të improvizuar ndoshta. Më të shpejtë, më pak burokratike".

Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", zëvendësambasadorja e Spanjës në Shqipëri, Eva Mendoza, tregon si nisi historia dhe kalendarin kulturor në vendin tonë.

**Si erdhi realizimi i këtij filmi?**

Është një histori personale e regjisorit. Gjithçka që fill me një udhëtim të babait të tij në vitin 1978, kur ishte pjesë e një delegacioni të

# EVA MENDOZA:

## Një film shqiptaro-spanjoll, historia nis më 1978-ën



Partisë Komuniste Marksisiste Leniniste, linja e fortë e të majtës antifrankiste. Ai udhëtim i la një mbresë të pashlyer. Një mbresë që ia transmetoi të birit përgjatë viteve dhe që e frymëzoi atë si regjisor. Në vitin 2005, ai erdhi për herë të parë në Shqipëri me të dashurën e tij në atë kohë, që më pas u bë bashkëshortja e tij e që sot është drejtoreshë e fotografisë e filmit. Marrëdhënia mes tyre lindi prej atij udhëtimi, kur jetonin në Gjermani për studime. Nisi kështu të kërkojë mbi Shqipërinë, që ai e quan një vend me një lloj mistike të veçantë. Ai ka thënë se është një vend ku i pelqen të kthehet. Ai erdhi për shkak të një historie personale dhe më pas u bë një vend me të cilin kishte lidhje të vetat. Ajo që ne si ambasadë po përpiqemi të bëjmë, është se po përpiqemi të gjejmë lidhjet që kemi dhe po zbulojmë gjëra të përbashkëta mes Spanjës dhe Shqipërisë, ndaj për ne ky film është shumë i rëndësishëm, sepse është hera e parë që një prodhim spanjoll është xhiruar i gjithi në Shqipëri, me një histori shqiptare e aktorë shqiptarë. Duke parë të gjitha këto, shpresojmë që kjo të jetë nisja e diçkaje më të madhe.

**Si pritet filmi në Spanjë?**

Për Spanjën ishte fantastike, sepse ishte një zbulim. Është shfaqur në festivale dhe tani shfaqet në kinema. Kushdo që e ka parë filmin në Spanjë është magjepsur, sepse për ta, kjo është ende një tokë për t'u zbuluar dhe e panjohur. Megjithatë ne kemi tashmë në duar statistikat dhe jemi të lumtur të zbulojmë se tri vite më parë ka pasur 7 mijë spanjollë në vit që vinin për të vizituar Shqipërinë dhe tani, vitin e kaluar kishte 24 mijë spanjollë që kanë ardhur në Shqipëri.

**Aktorët më të mirë sh-**

**qiptarë janë në film. A do ketë bashkëpunime të tjera pas këtij?**

Shpresoj që po. Kanë folur për një bashkëpunim magjik. Nuk di të them sot çfarë do të them, por uroj që do të ketë bashkëpunime të tjera.

**Ambasada e Spanjës ka një kalendar shfaqjesh filmash. A është pjesë e programit tuaj në Shqipëri?**

Çështjet kulturore janë pjesa që na intereson më shumë. Filmi na intereson shumë, sepse për shkak të buxheteve është mënyra më e mirë për të treguar kulturën e një vendi, ndaj ne kemi programe të përmuajshme të shfaqjes së filmave. Janë të premtet e filmave në "Marubi". Në kinemanë e Kuçovës do të çojmë javën e Kinemasë Spanjolle dhe organizojmë edhe ditën e filmit të shkurtër më 21 dhjetor, që është dita më e shkurtër e vitit. Një mënyrë tjetër është bashkëpunimi për promovimin e gjuhës me Fakultetin e Gjuhëve të Huaja e departamentin e spanjishtes. Sa i takon letërsisë, përveç një shfaqjeje me studentët e Arteve, do të ketë edhe lexime publike të "Don Kishotit".

**Duke qenë se jemi të "Don Kishotit", një prej prave më të lexuara në Shqipëri. Ju, si një njeri që keni diçka më shumë se një vit në Shqipëri, a e keni gjetur këtu "Don Kishotin", ose njeriun idealist që lufton me çdo gjë? A keni hasur të tillë?**

Mendoj se po. Nga ana kulturore, mendoj se kam gjetur këtu njerëz të mahitshëm të brezit të ri, që janë të zotët e bëjnë gjëra të bukura e të mëdha për vendin e tyre e për vetë dhe kanë ide që mund të ndikojnë të jetët e tjerëve. Sa për shembull, ne kemi një çmim për të rinjtë në botë, që kanë bërë ndryshim në jetët e tjerëve. Këtë çmim do t'ua sugjerojmë edhe të rinjve në

*Zëvendësambasadorja e Spanjës, në Shqipëri për projektin filmik dhe kalendarin kulturor*

**luftës civile, ka shkruar një vepër, ku flitet për luftën e për dashurinë nën titullin "Hasta La vista". Ai dhe vepri e tij janë mbase pika lidhëse mes Spanjës dhe Shqipërisë...**

Me këto lloj lidhesh që ju përmendni, ne po përpiqemi të planifikojmë ngjarje kulturore, që sjellin ide interesante së bashku. Ne po organizojmë një takim, që krahason ose vë përballë mes dy periudhave kohore të tranzicionit nga komunizmi në demokraci e në Spanjë nga diktatura e Frankos në demokraci. Ky takim do të jetë një lloj debati mes artistëve shqiptarë e span-

jollë, kryesisht nga kinemaja, por edhe ekspertë për të treguar se si ishte të krijoje në atë kohë.

**Pra, si mbijetuan e si krijuan gjatë regjimeve?**

Ata do tregojnë si i shohin periudhat tranzitore dhe mendoj se do jetë interesante, sepse kanë qenë krejt të ndryshme, por qasja artistike mund të ketë pika të përbashkëta dhe nga ana e çështjeve kulturore, mendoj se do ketë ide interesante dhe ato që do të thuhet, do të botohen për të dhënë panoramën mes dy vendeve dhe kjo do të jetë një urë mes dy vende që kanë shumë ngjashmëri.



PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Njofton se duke filluar nga data 16 Prill 2019 çmimi maksimal i shitjes me pakicë për 1 paketë për produktet e mëposhtme të duhanit me ngrohje është si vijon:

Nr	Përshkrimi i Produktit	Çmimi prej datës 16.04.2019 (përfshirë TVSh-në)
1	HEETS (SILVER LABEL)	320 Lekë/ paketë

Njoftimi bëhet në përputhje me Udhëzimin nr. 2, datë 28.1.2010 të Ministrisë së Financave "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" (i ndryshuar).

PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Rr. Murat Toptani , Qendra e biznesit Eurocol, Kati i 10,  
1000 Tirana, Albania  
Tel: +355 42 276 670

## KONCERTI

# Nga "La Scala" tek Artet, rikthehet në skenë violinistja kryeqytetase Suela Piciri

Dita e enjte solli në skenën e Universitetit të Arteve koncertin e violinistës Suela Piciri dhe pianistit Klevis Gjergji. I mbajtur falë mbështetjes së Ministrisë së Kulturës, si një ndër projektet fituese të vitit 2019 dhe me një program mjaft të guximshëm, koncerti i duos Piciri-Gjergji paraqiti kryevepra të literaturës botërore nga tre kompozitorë mjaft të ndryshëm nga njëri-tjetri, përsa u përket qasjeve estetike dhe elementëve karakterizues. Sigurisht që interpretimi i sonatave për piano dhe violinë nga autorë të tillë si Beethoven, Brahms dhe Debussy është një sipërmarrje aspak e thjeshtë për interpretuesit, por sikurse rezultoi, siguron një variacion të mirëpritur nga publiku kryeqytetas. Suela Piciri, diplomuar në Universitetin e Arteve, i rikthehet skenës së saj mbas një periudhe shumëvjeçare. Me një karrierë të konsoliduar në Itali, në një nga teatrot më të rëndësishëm sikurse është "La Scala" e Milanos, Piciri rikonfirmoi cilësitë e saj artistike duke dëshmuar pjekurinë artistike të një violinisteje karriere. Gjergji, diplomuar në Spanjë, me një sërë specializimesh në Holandë dhe Austri, ndërkohë që doktoraturën për piano e ka mbrojtur në Beograd, ngjitej për të disatën herë në skenën e Universitetit të Arteve dhe sikurse në koncertet e mëhershme, qoftë solistike e qoftë nën shoqërimin e orkestrës së RTSH, përmbushi pritshmëritë e publikut, që tashmë e njeh dhe surprizoi atë të ri, sidomos përsa u përket aftësive vetëkontrolluese në raport me violinistën Piciri. E themi këtë sepse, sikurse dhe u konfirmua nga vetë artistët, ishte hera e parë që interpretimin së bashku dhe për më tepër, nisur nga angazhimet e të dyve, mundësitë për prova ishin disi të reduktuara. Sonata Nr. 5 op. 24 e Beethoven-it, e quajtur "Frühlingssonate", thënë shqip "Sonata e Pranverës", titull ky që nuk i atribuohet vetë Beethovenit, hapi programin e duos Piciri-



*Në shoqërinë pianistit Klevis Gjergjit sollën kryeveprat botërore*

Gjergji. Vepra fillon në një sintoni të kënaqshme, udhëhequr nga melodja e violinës nën shoqërimin e pianos, role këto që pak më mbrapa, sikurse edhe shpeshherë përgjatë veprës, do të këmbehen. Interpretimi vjen i përmbajtur, thuhet në sordinë, por të dy instrumentistët krijojnë një marrëdhënie të këndshme reciprociteti materializuar natyrisht përgjatë rrugëtimit të veprës. Kalimi nga njëra kohë në tjetrën pasqyron bindshëm logjikën e unitetit ndërtuar me mjeshtëri nga Beethoven. Programi pasohet nga Sonata Nr. 2, op. 100 në Do maxhor e Johannes Brahms, të cilën në vend të... për violinë dhe piano, për të respektuar titullin dhënë nga vetë Brahms-i, duhet ta quajmë... për piano dhe violinë. Dëshirën për të barazuar rolet e të dy instrumenteve, e pse jo për t'i dhënë rol kryesor pianos, Brahms-i e shpërfaq që në fillim të veprës, duke i besuar vërshimin e temës së parë pianos. Sonata Nr. 2, e njohur edhe si "Thun" ose "Meistersinger Sonata", tituj këto të fundit për të cilët ka mjaft spekulime, konsiderohet si sonata më e vështirë për piano dhe violinë ndër tri sonatat e kompozuar nga mjeshtri i madh për këto instrumente. Gjithsesi, Piciri dhe Gjergji

ia dalin mjaft mirë të realizojnë një paraqitje mëse dinjitoze, madje edhe në pasazhet e vështira kontrapunktoke, duke evidentuar qartë materialin tematik tek secili prej instrumenteve në alternimet e vazhdueshme dhe aspak të thjeshta ritmikisht. Sonata për violinë dhe piano në Sol minor e Claude Debussy ishte përzgjedhur si vepra përmblyëse e koncertit. Historia e muzikës na dëshmon se kjo ishte edhe vepra e fundit e kompozuar prej Debussy, pavarësisht faktit se ishte parashikuar si pjesë e një cikli prej gjashtë sonatash. Në fakt, vendosja e kësaj vepre në fund të programit, sikurse dhe renditja e veprave në tërësi, rezultoi në një crescendo jo aq kohore sesa cilësore. Loja në sordinë, thuhet e ndrojtur, në fillim të programit me Beethoven, tashmë ia kishte lënë vendin finesës së Debussy-s dhe sigurisë interpretuese të sjellë me një tingëllim mjaft më rezonues. Ndryshimet e bëta të dinamikave interpretohen me mprehtësi nga Piciri-Gjergji, ndërkohë që secili prej tyre është në kontroll të plotë përgjatë pasazheve virtuozes jo të pakta në këtë veper. Debussy në këtë veper ka preferuar transformime të menjëhershme qoftë në di-

namika dhe tesiturë, e qoftë në figura ritmike. Sigurisht që një procedurë e tillë paraqet vështirësi për çdo instrumentist dhe publiku në sallë nuk mund të bënte gjë tjetër veçse të admironte sigurinë me të cilën Suela Piciri dhe Klevis Gjergji ia dilnin interpretimit të tyre notë mbas note e masë mbas mase. Por besojmë se cilësia dhe profesionalizmi me të cilin u interpretuan veprat ia vlejti, që kurse menjëherë mbas notës së fundit publiku vërshoi në duartrokitje, të cilat i detyruan artistët të ktheheshin disa herë në skenë. Koncerti i duos Piciri-Gjergji

mbahet në kuadër të një turneu, të cilin instrumentistët po e zhvillojnë në Shqipëri dhe Kosovë. Takimi i radhës do të jetë në 22 prill në festivalin "Chopin Fest" mbajtur në Prishtinë. Në fakt, një mënyrë e tillë organizimi e aktivitetit koncertor përbën një praktikë të kahershme në mbarë botën. Ndoshta kjo do mund të ishte një zgjidhje e zgjuar edhe për vendin tonë e disa vende të rajonit, në mënyrë që sikurse në rastin konkret, të sigurohen koncerte cilësore nga profesionistë, të cilët nuk mungojnë as brenda e as jashtë vendit.



**INVITATION TO BID**  
**No. OSCE PIA/ITB/SALE/2018/01**  
**SALE OF SURPLUS OSCE PRESENCE IN ALBANIA VEHICLE**

The OSCE Presence in Albania (OSCE), located at MAK ALBANIA HOTEL, 1-st Floor, Sheshi "Italia", 1010, Tirana, Albania intends to sell certain surplus vehicle as described in the Bidding Documents.

A complete set of the Bidding Documents can be obtained upon email request sent at [procurement-al@osce.org](mailto:procurement-al@osce.org)

Proposals must be delivered to the below specified address on **Friday 03 May 2019, 13:00hrs** in a sealed envelope and marked as follows:

=====TENDER-DO NOT OPEN=====  
**Procurement Section**  
**OSCE Presence in Albania, MAKALBANIA HOTEL, 1st floor, Sheshi "Italia", 1010, Tirana, Albania**  
**Subject: Sale of surplus vehicle**  
**Ref: OSCE/ITB/SALE/2019/01**  
**Due date: 03 May 2019, 13:00hrs (CEST)**

Proposals sent by email and facsimile will NOT be accepted. The OSCE reserves the right to accept or reject any Proposal, and to annul, in whole or in part, or to suspend the solicitation process and reject all Proposals at any time and without reason prior to award.



# BLUE TOOTH

Thashetheme  
MADE IN ALBANIA

Nr. 657

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE Redaktore: Pamela Aliaj - Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtunë 20 Prill 2019

## SAIMIR TAHIRI BEHET BABA PER HERE TE DYTE, VJEN NE JETE GOLIK



**Pamjet e para të vogëlushit disaditësh pranë të atit**

## "PRESTIGE RESORT" PRET TURISTËT E PARË

Ja vajzat e famshme që e zgjodhën për relaks



**RIKTHEHET**

## MARINA FARA

E vërteta e shtatzënisë



*"Kam bërë shumë sakrificë për dashurinë"*


## NUK FSHIHEN MË!

ERIK FULLANI DHE KEIDA  
KALOJNË NATËN BASHKË!



## Linda Halimi çon vajzën në studio, së shpejti kënga e re

**K**a kaluar një muaj që kur këngëtarja, Linda Halimi u bë nënë për herë të parë. Këngëtarja shqiptare, e cila jeton prej vitesh në Amerikë, Linda Halimi në mars u bë nënë e një vajze. Dhe tani, Linda ka publikuar një fotografi në llogarinë e saj, 'Instagram', ku shihet në studio bashkë me vajzën. "U ktheva në punë... dhe Kaimana duhet të dëgjojë këngën e para", ka shkruar Linda. Linda prej kohësh jeton në Amerikë me bashkëshortin e saj, reperin e njohur, Big D.




## Provokon keq Enca me të pasmet, këshillë vajzave

**K**ëngëtarja e njohur, Enca këshillon që të bëni 'twerk' të paktën një herë në ditë. Ajo nuk e ka ndërmend t'i ndal provokimet si gjithmonë. Në disa imazhe në 'InstaStory' derisa bënte 'Twerk' duke provokuar me të pasmet dhe format e trupit. Ajo përmes fotografive ka dhënë edhe disa mesazhe, 'Mirëmëngjesi, mos harroni të bëni 'twerk' ka shkruar në një nga foto ndërsa në një tjetër ka shkruar "Pak twerk në ditë, mban doktorin larg një vit". Provokimet e tilla janë të prishme nga këngëtarja e cila vazhdimisht bën gjëra të tilla. Kujtojmë, që ditë më parë Enca ka qëndruar në Prishtinë për të punuar për projekte të reja.

## Nuk fshihen më! Erik Fullani dhe Keida kalojnë natën bashkë!

**P**rej kohësh është përfolur në media të ndryshme se vajza e ish-deputetes Majlinda Bregu, Keida dhe djali i ish-Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Erik Fullani janë në një lidhje. Fillimisht ishin disa postime në rrjetet sociale të Erikut dhe Keidës ato që tërhoqën vëmendjen e të gjithëve dhe që shtuan dyshimet për një romancë të mundshme. Më pas ata kanë vizituar të njëjtat vende, në të njëjtën ditë dhe me veshje të njëjta si dhe, gjithashtu, janë fotografuar bashkë. Siç duket çifti tashmë ka vendosur që të mos fshihet më. Teksa më përpara kujdeseshin për postimet e tyre, tashmë Keida dhe Eriku nuk ngurrojnë që të publikojnë foto nga i njëjti vend. Ditën e enjte ata kanë qenë të pranishëm në një vend bregdetar dhe në postimet e publikuara shihen në të njëjtin ambient teksa po shijojnë pamjen, duke përfurcuar kështu aludimet që janë bashkë.



## Habit Arbenita, tregon me krenari strijat në vithet e saj

**A**rbenita Ismajli u kthye në një prej vajzave më të përfolura në mediat online për bukurinë e saj dhe lidhjen me reperin Fero. Modelja njihet për pamjen e saj natyrale dhe një bukuri që i tërhoqi vëmendjen e të gjithëve me daljen e parë. Ajo është mjaft aktive në llogarinë e saj në 'Instagram' dhe kujdeset deri në detaj për çdo foto që publikon duke na surprizuar kështu gjithnjë e më shumë. E njëjta gjë ndodhi për foton e fundit që publikoi në 'Instastory', por që nuk qëndroi gjatë aty sepse modelja seksi e fshiu. Arbenita publikoi një foto me bikini dhe me shumë krenari tregonte që ka strija.

# "Prestige Resort"

## pret turistët e parë, ja kush janë dy vajzat me famë botërore që e zgjodhën për relaks

**N**jë bionde sensuale dhe një brune seksi kanë bërë përsh typte me pamjen dhe prezencën e tyre, pasi kanë vendosur të akomodohen për të pushuar në resortin "Prestige" tek Mali i Robit. Fjala është për dy vajza të famshme në botë, missin dhe modelen bionde Natalia Bush si dhe prezantuesen televizive nga Afrika e Jugut, Bonang Matheba. Nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën pasi secila ka famën e saj, por në këtë rast i ka lidhur zgjedhja e njëjtë për të pushuar pranë detit duke prenotuar dhomat e tyre në "Prestige Resort". Të dy vajzat e njohura kanë bërë shumë foto në ambientet e resortit, për të ruajtur si kujtime mbresat e veçanta nga gjithçka që shijuan duke filluar nga ambienti luksoz, shërbimi perfekt, kuzhina e shijshme dhe e larmishme dhe njerëzit që takuan. "Bluetooth" ju sjell fotot e vajzave VIP që vijnë të pushojnë në Shqipëri. 35-vjeçarja Natalia Bush bën përshlytje me linjat e saj si në vitin 2005, kur u shpall "Miss Tenerife". Ajo aktualisht punon si modele, showgirl e aktore dhe jeton në Itali, prej gati 15 vitesh. Në fund të 2007-ës ajo pozoi për kalendarin nudo të revistës spanjolle "Interviú", ndërkohë që është e gjatë lista e projekteve televizive ku ajo ka qenë protagoniste kryesore. Natali ka një pamje fizike që të lë pa fjalë, vlerat sensuale. Ndërsa 31-vjeçarja afrikane Bonang Matheba, e njohur si Queen B', ka një karrierë të pasur si: prezantuese radio e televizioni, aktore, producente, businesswoman e filantrope që nga viti 2007. Ajo njihet si një nga afrikanet e para me ngjyrë që ka pushuar kopertinat e revistave të njohura. Kujtojmë që "Prestige" është shndërruar në resortin e preferuar për të famshmit e botës, të cilët zgjedhin Shqipërinë për të pushuar. Edhe vjet, sapo u hap sezoni i verës, në Resort u shfaqën fytyra të njohura të showbizit në botë. Misse, aktore, këngëtare, balerina, prezantuese, blogere, koreografë etj, kjo është lista e gjatë e personazheve të njohur që zgjidhën "Prestige Resort" edhe pse shumica prej tyre nuk kishin qenë asnjëherë në Shqipëri dhe vendin tonë e njohën nëpërmjet një investimi privat gjigand me parametra perëndimorë në çdo aspekt siç është "Prestige Resort". Menaxherët e kompleksit rrëfejnë se edhe këtë herë ka patur shumë kërkesa për të pushuar aty dhe ne do kemi rastin të shohim me siguri fytyra të famshme në vendet e tyre, të cilët vijnë të eksplorojnë një destinacion të ri, siç është "Prestige Resort".

*Modelja e famshme spanjolle dhe moderatorja seksi afrikane, bukuroshet që do pushojnë në resortin e famshëm shqiptar*





Nga Bleona Qereti te Venera Lumani, të famshmit që dolën sheshit

# Perfekte apo natyrale?

## VIP-at që pranuan ndërhyrjet në trupin e tyre

*Dikush me strija e kush me bark jo të sheshtë, çfarë ndryshimesh bënë në pamje*

Pamela Aliaj

Të kesh një trup perfekt dhe një fytyrë të përsosur është shumë e vështirë ditët e sotme, sidomos nëse je personazh i njohur. Ndërhyrjet nga format e vendet më të ndryshme janë bërë tendencë tashmë dhe falë fotove që postojnë, ne me sy të lirë arrijmë të shohim diferencën. Por të rrallë janë ata VIP-a që i pranojnë këto ndërhyrje, dhe jo sepse janë kapur mat, por sepse e pranojnë me krenari, disa prej tyre, dhe domosdoshmëri një proces të tillë. Më poshtë ju listojmë vetëm disa prej tyre që patën kurajën që të parat të pranoinin se kishin bërë dhe bëjnë ndërhyrje estetike në pamjen e tyre. Epo në fund të fundit, siç ka thënë dhe Beyonce në një nga këngët e saj, "beauty hurts" (bukuria të dhemb)!

### FJOLLA MORINA

Fjolla Morina ka pranuar publikisht dhe pa hezitime se ka bërë ndërhyrje në trupin e saj. Pas shumë kohësh si personazh publik këngëtarja pranoi se doktori plastik ka ndërhyrë mjaft në jetën e saj. E ftuar në emisionin Zonë e Lirë në Klan Tv, ka thënë se ka



fryrë buzët, sepse këtë e bëjnë të gjithë tani. Ndërsa e pyetur nga Arian Çani nëse i ka bërë të pasmet, Fjolla e ka pranuar edhe këtë! "Pas lindjes së vajzës hoqa dhjamin nga barku dhe e vura tek të pasmet dhe tani duken bukur", -ka thënë Fjolla.



### VENERA LUMANI

Ajo është një nga këngëtaret më të njohura dhe më të dashura të showbiz-it shqiptar. Venera Lumani është shpallur si zëri më i mirë shqiptar gjatë edicionit të dytë të "The Voice of Albania". Ndërkaq ajo ka kryer një ndër-

hyrje kirurgjikale, që nuk heziton të ndajë me fansat dhe publikun që e ndjekë atë. Në programin "Pop Culture" në Top Channel, Lumani tregon se ka bërë hundën operacion.

### BLEONA QERETI

Është një nga këngëtaret më të famshme e të përfollura shqiptare, e cila pas suksesit në vendin tonë po vazhdon karrierën edhe jashtë vendit. Aktive në rrjetet sociale ajo ndan shpesh me fansat momente nga jeta e përditshme, projektet e reja etj., por një postim në veçanti ka habitur jo pak. Bleona ka publikuar një video duke realizuar një konsultë me kirurgun plastik Simon Ourian, i cili ka si klientë emra të njohur të Holivudit si Kim Kardashian, Lady Gaga, Miley Cyrus, Iggy Azalea dhe të gjitha motrat e Kim-it. Këngëtarja shqiptare ka bërë të ditur se do të realizojë atë që quhet 'konturimi i nofullës', e cila konsiston në krijimin e mprehtësisë së nofullave pa kirurgji të mirëfilltë estetike. Nuk e dëgjojmë

shpesh në showbiz që një këngëtare të pranojë ndërhyrjet në fytyrë të cilësdo natyrë.

### FLAKA KRELANI

Këngëtarja ka pranuar se ka realizuar disa ndërhyrje, e kjo është hera e parë që Krelani flet publikisht për këtë pjesë. "Nuk ka preferuar t'i përgjigjem kësaj pyetje, por ndjej se ka ardhur koha të jem e sinqertë me publikun", -është shprehur fillimisht Flaka. "Të gjithë bëjnë ndërhyrje në ditët e sotme që të ndihen mirë. Unë dua të dukem bukur në skenë. Nuk mendoj se ka diçka të keqe këtu", -ka shpjeguar këngëtarja.

### GENTA ISMAJLI

Fotot e kohëve të fundit, me një pamje tjetër të këngëtares së njohur shqiptare Genta Ismajli, kanë ngjallur dyshime e komente edhe në rrjetet sociale. Ka bërë apo nuk ka bërë ndërhyrje plastike? Make up-i i rënduar, flokët me nuancë më të çelur, por edhe ndonjë ndërhyrje e vogël (e dyshuar) e Gentës në fytyrë i kanë dhënë asaj një pamje të re, ndryshe nga ajo që kemi njo-



Lind djali i dytë i ish-ministrit të Brendshëm

# Saimir Tahiri bëhet baba për herë të dytë, vjen në jetë

## GOLIK

*Pamjet e para të vogëlushit disaditësh pranë të atit*



Pamela Aliaj

Vetëm dy javë më parë njoftuam nga burime për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare" se bashkëshortja e ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri, Fatlinda Berisha ishte në ditët e fundit të shtatzënisë. Ndërkaq pritjes i ka ardhur fundi! Vetëm pak ditë më parë erdhi në jetë djali i dytë i familjes Tahiri, Golik. Me një emër tepër interesant ai që kanë

zgjedhur për vogëlushin, që të kujton këngëtarin e polifonisë Golik Jaupin, me të cilin Tahiri ka postuar dhe një video kohë më parë kur ishte ministër. "Im bir, Goliku", shkruan Tahiri teksa i prezanton botës, djalin e vogël. Tahiri dhe bashkëshortja e tij Fatlinda Berisha, kanë edhe një djalë më të madh 8 vjeçar, Drinin dhe tashmë familja u kompletua me një tjetër djalë.



hur. Ndërhyrjet në fytyrë të Gentës janë kthyer diskutim, ndaj, për t'u dhënë fund të gjitha komenteve lart e poshtë, Genta ka pranuar publikisht çfarë ka ndryshuar te vetja. E ftuar në 'Prive' për të rrëfyer projektet e reja dhe planet e këtij viti, Genta nuk i ka shpëtuat dot pyetjes për ndërhyrjet plastike, pas së cilës është treguar e hapur: "Përveç buzëve që i kam bërë përkohësisht, i kam mbushur pak, sepse gjithmonë kam pasur qejf t'i kem buzët e trasha dhe kur ka dalë filli për t'i bërë buzët e trasha jam gëzuar shumë, asgjë tjetër. E adhuroj Angelina Jolie dhe ia dua shumë buzët dhe kam qejf që t'i bëj ashtu, madje edhe më shumë kam qejf", - thotë Genta. Por përveç buzëve, nuk ka bërë asnjë ndërhyrje tjetër: "Operacione plastike nuk kam, nuk kam bërë askund dhe as nuk



mendoj të bëj. Ndoshta kur të jem 70 - 80 vjeç, nëse jam gjallë, por tani jo. Nuk kam asnjë operacion plastik. Unë s'e di pse po e keqkuptojnë operacionin plastik me

një mbushje të vogël, ndërhyrje".

### IRMA LIBOHOVA

E ftuar në emision "E di-ell" këngëtarja e njohur e muzikës shqiptare Irma Li-



bohova ka pranuar se ka kryer ndërhyrje estetike në portretin e saj. Megjithatë ajo i ka cilësuar këto ndërhyrje si normale për moshën e saj dhe duke

theksuar se do të ishte mirë që vajzat e vogla 20-vjeçare të mos i kryenin. "Kam bërë ndërhyrje të vogla, në moshën time janë normale, uroj mos t'i bëjnë të voglat, vajzat 20 vjeçare", -u shpreh ajo.

### ALBËRIE HADËRGJONAJ

Ajo është ndër këngëtare e pakta që e ka pranuar se në fizikun e saj, ka kryer ndërhyrje estetike. Albërie Hadërgjonaj, e pranon se bën botox herë pas here dhe se i ka mbushur buzët, ndërsa në publikimet e fundit në 'Instagram', ajo thotë se ka shkuar te një kirurg, për të ndërhyrë në rrathët e zisë poshtë syve. Këngëtarja tregon hap pas hapi se cilat ndërhyrje do i kryejë e madje ka edhe një porosi: "Kujdesuni për veten, për burrat e për dashnorët tuaj. Secila duhet të duket bukur", -ka thënë këngëtarja.

Rrëfhet vajza e këngëtares Eli Fara: Ja motivi më i shtrenjtë i jetës sime

# Rikthehet Marina Fara: E vërteta e shtatzënisë

## “Kam bërë shumë sakrifica për dashurinë”



Pamela Aliaj

Shumë prej jush e mbajnë mend si vajzën e këngëtares së njohur të këngës së lehtë dhe popullore, Eli Fara. E diplomuar për avokati, Marina Fara parapëlqen edhe fotografinë dhe modelingun. Para disa kohësh u përfol nëpër media për një shtatzëni të mundshme të Marinës si dhe për faktin se shumë shpejt do të bëhej nënë. Por pas këtyre lajmeve vetë Marina zgjodhi të zhdukej nga rrjetet sociale duke u rikthyer sërish tani. Por çka ndodhur me të ndërkohë? Pse ajo zgjodhi të heshtë pas lajmeve që do të bëhej nënë? Në një intervistë ekskluzive për “Bluetooth” të “Gazeta Shqiptare”, Marina ka rrëfyer të gjitha të vërtetat për herë të parë. “Besoj se të gjithë sakrifikojnë në momentet kur janë të dashuruar. Nuk mund ta përcaktoj deri ku mund të arrij, por sakrifica kam bërë”, -ka thënë Marina.

Këto e shumë detaje të tjera në intervistën e më-



poshtme:

**Prej shumë kohësh jeni shkëputur nga rrjetet sociale dhe vëmendja e medias. Me çfarë është marrë deri tani Marina?**

Mendoj që ka momente që çdo njeri ka nevojë për qetësi dhe privatësi dhe aq më tepër kur çdo ditë e më tepër shumë media e portale më shumë dezinformojnë sesa informojnë. Gjithë këto kohë jam përqendruar te projektet e reja që kam, si dhe rim-bushjen e vetes me energji të reja.

**Keni nisur para disa kohësh një projekt fotoshooting dhe modelingu. A keni në plan të bëni një të dytë?**

Fotoshooting është dhe do të ngelet një nga pasionet e mia më të dashura. Po angazhohem me më shumë se një projekt. Gjithashtu, edhe në fushën e modelingut. Ëndrrat tashmë janë jashtë sirtarit, por koha do ta tregojë.

**U përfol nëpër media më parë për një shtatzëni të mundshme tuajën. Si qëndron e vërteta?**

Ishte një fotoshop dhe e kam thënë disa herë. Aspak lajm i vërtetë. Nuk më ka pëlqyer kurrë politika, por një shprehje e kryeministrit tonë aktual m'u nguliti në kokë “kazani ka bërë punën e vet”.

**Marina është e dashuruar, single, apo në kërkim të dashurisë?**

Ndihem e lumtur nga njerëzit që kam pranë. Është një fazë e jetës që po e shijoj dhe më ka bërë të ndihem mirë.

**Vijoni me profesionin e avokates apo keni dëshirë të ndërmerrni diçka të re në jetën tuaj si profesion?**

Profesionin e avokates nuk e kam praktikuar shumë, sepse kam qenë e angazhuar me projekte të tjera. Por kurrë nuk duhet thënë kurrë.

**Si një vajzë tepër tërheqëse, me siguri që mund të keni shumë propozime apo edhe ngacmime në vendet që frekuentoni. A ju bezdisin? Si reagoni?**

Momentet sikletit një femër ka gjithmonë në jetën e saj nga ngacmimet e meshkujve. Ky besoj se është problem jo vetëm në Shqipëri, por edhe në të gjithë botën. Mundohem t'i anashkaloj me qetësi dhe mirësjellje.

**Për çfarë mërzhitet më tepër tek ju mami juaj, Eli Fara?**

Mami im është gjëja më e shtrenjtë që kam në botë! Nuk e di në mund t'ia shpërblej dot ndonjëherë atë çfarë ka bërë për mua. Ajo si çdo nënë kërkon më të mirën për mua. Është lumturia më e madhe e jetës sime.

**Cila është sakrifica më e madhe që do bënit për dashurinë?**



Besoj se të gjithë sakrifikojnë në momentet kur janë të dashuruar. Nuk mund ta përcaktoj deri ku mund të arrij, por sakrifica kam bërë!

**Personi juaj ideal për të ndërtuar një të ardhme duhet të ketë 3 elemente kryesore që janë...**

Personi im ideal që mendoj për të ndërtuar një të ardhme mendoj se nuk mund ta përcaktoj dot vetëm me tre elemente! Mendoj që sinqeriteti, dialogu dhe besimi te njëri-tjetri është çelësi i një marrëdhënie të shëndoshë.

**Çfarë do të donit të ndryshonit te vetja juaj?**

Përmirësimin e kërkoj çdo ditë e më shumë në jetë. Ky është çelësi i jetës besoj, të përmirësohem çdo ditë të jetës sonë.

**Cili është motivi apo shprehja që ju motivon më tepër?**

Motive kam shumë që më frymëzojnë. Kryesorja është gjithmonë mamaja ime që ka qenë gjithë jetën burim motivimi. Shprehja që më motivon më shumë është “nesër është një ditë e re”.

## Era dhe Nora të publikojnë këngën, ja pse vonuan

**E**ra dhe Nora Istrefi kanë publikuar dje me videoklip këngën 'Nuk e di'. Ka shumë kohë, muaj madje, prej kur është konfirmuar se motrat Istrefi po vijmë me një këngë bashkë, bashkëpunim ky që

është kërkuar shumë nga fansat e të dyja artisteve. Lajmi se ata po bëhen bashkë për një këngë i ka gëzuar shumë këta fansa, por ata edhe kanë pritur që kënga të publikohej sa më shpejtë. Megjithatë, duket se videoklipi i ka vonuar mjaft shumë, pasi është një realizim që padyshim ka kërkuar shumë kohë. Videoklipi



përfshin 8 skena, prej të cilave 4 janë të Erës, një vetëm e Norës, dhe në dy skena shfaqen bashkë, në skenat epike ku shihen me flokë të lidhura me njëra-tjetrin. Ndërsa videoja që ka dalë mjaft artistike, përfshin një skenë ku gjatë muzikës shihen dy silueta të valltarëve duke vallëzuar me drita fosforike me ngjyrë në duar. Ideator i këtij klipi është bashkëpunëtori i ngushtë i Erës, artisti Astrit Ismaili ndërsa Entermedia është përkujdesur për xhirimin. Valdrin Sahiti dhe Sellma e Kaçi janë përkujdesur për dukjen dhe stilin e këngëtareve, ndërsa Albi Nako ka bërë koreografinë. Kënga është punuar nga Claydee në bashkëpunim me Erën dhe UltraMusic dhe është publikuar në nivel global nga Ultra, shtëpia muzikore pjesë e të cilës është Era.



## Këngëtarja e sjell për të xhiruar videoklipin, reperi algjerian flet edhe shqip

**R**eperi algjerian ka kaluar disa ditë në Shqipëri dhe i rrethuar nga shqiptarë. Dhurata Dora dhe Soolking gjatë ditës së djeshme do të publikojnë me videoklip këngën e tyre të shumëpritur, 'Zemër'. Kënga e cila është në gjuhën shqipe dhe franceze, ka ditë që po qarkullon nëpër internet dhe fansat po e pëlqejnë aq shumë, sa që pritet të shndërrohet në një hit të vërtetë. E videoklipi për këtë këngë është realizuar në Shqipëri, skenat për të cilin kanë xhiruar të dy artistët. Në një postim të Dhuratës ku tregon se kënga tanimë mund të dëgjohet në platformat muzikore dhe se dje do të dalë edhe në Youtube, vërehet një koment i Soolking në gjuhën shqipe. Ai shkruan: "Ju dua ok", duke etiketuar Dhuratën në koment.

## Për pak lind, Almeda Abazi bën blerjet e fundit për djalin

**I**sh-Miss Shqipëria Almeda Abazi dhe bashkëshorti i saj Tolgahan janë në pritje të fëmijës së tyre të parë. Shumë shpejt djali do të vijë në jetë, pasi bukurshja me origjinë shqiptare është në muajin e fundit. Blerjet dhe shpenzimet për të voglin kanë qenë të shumta dhe të mëdha. Disa prej tyre Almeda i ka ndarë me të gjithë qëkur e zbuloi shtatzëninë. Së fundmi ajo ka publikuar një foto të ndenjësës që përdoret për ta vendosur në makinë ose për ta mbajtur në duar tekta prindërit shëtitis me bebin. Emocionet e Almedës për gjithçka po përjeton vetëm shtohen ndërsa pritet po i vjen fundi. Kujtojmë se vetëm pak ditë më parë, Almeda rrëfeu në një intervistë ekskluzive për 'RevistaEho.Com', detajet dhe përjetimet e 9 muajve duke lënë të kuptohet se është më e lumtur se kurrë.



## Të lidhur apo jo? Habisin moderatorët: "Bashkë jemi, duhemi!"

**A**ta janë përfolur për një lidhje më tepër se shoqërore me njëri-tjetrin dhe shpesh u është dashur të përballen personalisht me kuriozitetin dhe dëshirën e fansave që i pyesin: A jeni bashkë? "Sa shkon si çift, pse nuk lidheni ju të dy", është një ndër komentet më të shpeshta që shohim në profilin e Ori Nebijaj dhe Islit Islamit në 'Instagram', sa herë që ata publikojnë një foto bashkë. Dhe pikërisht për t'u dhënë njëherë e mirë përgjigje këtyre pyetjeve, Ori dhe Islit kanë qenë të ftuar në emisionin "Pop Culture", ku kanë folur për marrëdhënien e tyre. "A jeni bashkë ju të dy?", i pyet moderatorja ndërkohë që Islit ia kthen "Bashkë jemi se s'jemi veç". "Moj duhemi ne?", pyet ai më pas kolegen Ori Nebijaj, e cila ia kthen: "Duhemi!" Sigurisht gjithçka ka qenë në formë shakaje pasi Ori edhe më herët e ka thënë e mes tyre ka vetëm shoqëri dhe asgjë më tepër.

Opinion

i Ditës

# Armëpushim?

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... me sprova (për fat të mirë të izoluar) për të frikësuar anëtarët e Kuvendit që mbledheshin, apo për të hyrë me forcë në sallë. Të enjten nuk e bëri diçka të tillë. Pas protestës së mbremjes së 13 prillit, drejtuesi i partisë kryesore opozitare në rrugë nuk caktoi ndonjë datë të muajit tjetër për protestën e përgjithshme të radhës (sikurse kishte bërë më 16 shkurt dhe më 21 mars). Në mbledhjen e kryesisë së partisë së vet po dje, ai kumtoi tri kushte që partia të hyjë në zgjedhje. Ngjatin disi më të zbutura nga gjuha revolucionare e përdorur këto dy muajt e fundit me përmbyse dhe tërheqje zvarrë. Dhe qytetarët që i shohin dhe i ndjekin me kujdes këto veprime dhe fjalë të drejtuesit opozitar ndihen disi më të çliruar nga ankthi i gjatë i rrugës pa krye ku ishte futur opozita. Sigurisht që edhe ajo e donte një zgjidhje tavoline. Mirëpo veprimi i saj i pasqoq i braktisjes së mandateve të përfaqësimit nuk solli largimin vullnetar të Qoftëlargut (për opozitën, kryeministri i sotëm). Dhe kryesorja, nuk nxori në rrugë qytetarë të pakënaqur dhe madje, edhe të revoltuar me qeverinë e sotme, të cilët janë vërtetë me dhjetëra mijëra, madje edhe qindra mijëra. Të cilët realisht mund të bënin që ndërko-



mbëtarët të ndërronin mendje dhe të konsideronin si të rëndësishëm veprimin opozitar, pse diktohej nga pakënaqësia e gjerë popullore. Një popull tri-katër herë më shumë në rrugë (madje jo vetëm në Tiranë) do të kishte përçarur një mesazh të qartë të dëshirës për përmbyse të kuzanit qeverisës. Mirëpo populli i pakënaqur (jo thjesht vetëm ai opozitar-militantët besnikë) nuk doli masivisht në rrugë, nuk e ndoqi opozitën e vetme dhe reale të vendit në marshimet rreth parlamentit dhe në aksionin e saj.

Këtë opozita e ndjeu, edhe pse me deklaratat dhe veprime fliste dhe mëtonte për të kundërtën. Prandaj kemi një sprapsje të lehtë të saj nga tensioni i skajshëm i protestave dhe nga fuçia e barutit e përshkallëzimit të dhunës. Prandaj, edhe drejtuesi i opozitës kryesore përmendi ndërhyrjen dhe veprimin e ndërkombehtarëve (të konkretizuar nga raporti i Reinhard Priebe) në zgjidhjen e tensioneve politike të skajshme të Maqedonisë së Veriut në vitin 2015. Ndoshta prandaj dhe nuk kemi një datë për pro-

testën e përgjithshme për në maj. Sikur opozita po pret një reagim nga ndërkombehtarët, që aq shumë e dënuan dhe anatantuan harakirin e saj politik, duke e braktisur në fatin e saj. Dhe pret e qetë, pa shigjetuar protesta të ardhshme, tension dhe rrezik për dhunë. Ndërkohë, pozita nëpërmjet kryeministrit po dje solli kumtin e gatishmërisë së vet për dialog. Kryeministri përsëriste "...jemi gati të pranojmë, të komunikojmë edhe të diskutojmë... Jemi gati të gjejmë mënyrën që të gjejmë një pit-

stop (ndalesë) në Parlament" në 45 minutat e fjalës së vet në Kuvend. A thua do arrijmë të kemi një armëpushim të pashpallur? A thua palët ndërluftuese (partia në pushtet nën komoditetin e mbështetjes dhe mirëkuptimit të plotë të ndërkombehtarëve) dhe opozita reale e vendit (e zhgënjyer thellë nga mosndjekja prej popullit të pakënaqur në aksionin e saj të pasqoq) do ta gjejnë një shteg dialogu? Këtë presim të gjithë, me zemër të dredhur. Opozita e karikuar nga harakiri i saj mprehu shpatat dhe shigjetat e dëbimit të Qoftëlargut nga pushteti. Por, nuk ia doli që këtë ndjesi apo tërbim dëbimi ta përçojë te qytetarët e pakënaqur të Shqipërisë. Në fakt, sa më shumë dhunë të dëshpëruar prodhonte, aq më të fortë e bënte Qoftëlargun. Prandaj dhe ngeli vetëm me militantët. Shpresa e saj e vetme është dialogu dhe bisedimet për kushtet e hyrjes së saj në zgjedhjet vendore të qershorit. Do të jetë një shteg shumë i vështirë për t'u hapur, për shkak të dëgjies së terrenit politik që ajo e parabëri më 18 shkurt me braktisjen e përfaqësimit politik të 475 mijë qytetarëve të këtij vendi, që e kishin votuar dy vjet më parë. Por, është rruga e vetme për të pakësuar faturnë qindra milionë euroshë, që ky vend po paguan nga betejat pa bukë dhe antagonizmi i pamoralshëm i partive tona politike. Uroj më të jetë një armëpushim real dhe që të zgjasë. Kemi nevojë të gjithë për pak qetësi.

## BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT MË VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE  
LAJMET E FUNDIT NE  
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

Opinion *i* Ditës

# Attention! Zgjedhjet nuk janë fushata grumbullimi patatesh

Nga Petrit Vasili

(vijon nga faja 1)

... antidemokratike, që janë të paimagjueshme për vendet e tyre.

Attention!! Alibia në anglisht me një fushatë grumbullimi patatesh, që po tentohet t'i behet krizës më të rëndë të përfaqësimit që ka përfshirë Shqipërinë është ndihma më e keqe për te dhe demokracinë e saj që rritet ngadalë dhe me shumë mundime.

Attention!! Parlamenti është sot thjesht një depo patatesh të kalbura pas një fushate grumbullimi patatesh të drejtuar nga qeveria e telekomanduar nga krimi i organizuar.

Attention!! Ky parlament or in english this parliament është thjesht një instrument i kriminalizuar, që ligjëron korrupsionin dhe asgjësimin e luftës ndaj krimit të organizuar.

Attention!! Çdo ditë e mëtejshme e këtij parlamenti është një ditë e mirë për krimin, por njëherazi një ditë e zezë për qytetarët.

Attention!! Demokracia lind mbi përfaqësimin dhe kur përfaqësimi i qytetarëve tronditet e asgjësohet demokracia vdes dhe çdo lëksion apo didaskali në anglisht është thjesht një zë në veshin e një të vdekuri.

Attention!! Promovimi i një tjetër fushate grumbullimi patatesh të kalbura në 30 qershor është thjesht një thikë tjetër në një krizë përfaqësimi, që ndodhet në buzë të humnerës.

Attention!! Zgjidhja i krizës së tmerrshme të përfaqësimit fillon nga zbardhja e dosjes 339 dhe 184, nga çuarja prapa hekurave të fajtorëve të grabitjes së zgjedhjes përmes krimit të organizuar dhe një thirrje e fortë për ta bërë këtë në shqip dhe anglisht do ta besonin të gjithë shqiptarët që i njohin fajtorët, por njohin edhe qeverinë



që i mbron ata e që nuk lejon t'i çojnë ata përpara drejtësisë.

Attention!! Shqiptarët presin një thirrje të fortë në shqip dhe anglisht që fajtorët e korrupsionit të Unazës së Re të shkojnë pas hekurave, presin që fajtorët që lanë aeroportin ndërkombëtar në dorë të 4 kriminelëve të shkojnë pas hekurave, presin të shkojnë pas hekurave ata që i bëjnë presion medias së pavarur, presin të shkojnë pas hekurave ata që pas-

trojnë paratë dhe rrënojnë ekonominë e Shqipërisë.

Attention!! Shqiptarët në këto 29 vjet pluralizëm përveç flamurit kuq e zi kanë valavitur pa u lodhur flamurin amerikan dhe më pas atë të Europës së Bashkuar.

As Amerika dhe as BE nuk kanë shndërruar senatet, dhomën e përfaqësuesve dhe parlamentet e tyre në vend grumbullimi patatesh të kal-

bura të krimit të organizuar.

Attention!! Edhe shqiptarët do të ecin vetëm në këtë rrugë dhe do të kenë vetëm këtë shembull të Amerikës dhe BE dhe kurrë nuk do të lejojnë që Republika Parlamentare ndër në të kthehet në vend grumbullimi patatesh të kalbura të krimit të organizuar dhe qeveria si një zgjatim i saj.

Kush ka kurajë le të thotë të kundërtën!!

**BLUE TOOTH**  
THASHETHEME MADE IN ALBANIA

te rejat nga jeta ipave

COO të shtunë TALAS me

## HOROSKOPI

**DASHI**  
Ashtu si një lojtar i mirë shahu, duhet t'i parashikoni lëvizjet e njerëzve të tjerë dhe të qëndroni disa hapa përpara. Kjo nuk është për konkurrencë, por për të mos humbur shumë kohë.

**DEMI**  
Më shumë njerëz se kurrë kanë rënë në dashuri me idetë tuaja dhe ata janë të interesuar të flasin me ju tani. Pra, jini me sa më shumë njerëz që të jetë e mundur dhe shijoni ndjenjën e të qenit një yll.

**BINJAKET**  
Të qenit i kujdesshëm me paratë nuk do të thotë se jeni koprac. Paratë tuaja janë tuajat për të shpenzuar, megjithatë mos i shpenzoni ato në gjërat e gabuara. Duke qenë një kalorës i keq nuk arrini asgjë.

**GAFORJA**  
Diçka brenda jush është pak e tensionuar sot. Qetësohuni. Ky shqetësim është shkaktuar ndoshta nga pasiguria që po ju rrethon. Shikoni faktet, dhe ju do të jeni në gjendje të qetësoheni. Mos lejoni që pesimizmi të jetë më i fortë sesa ju.

**LUANI**  
Modestia e re me është e shëmtuar, prandaj mos u ndjeni fajtor nëse ndiheni kërnarë. Sigurisht, nuk duhet të dini duke bëritur rreth asaj se sa të mrekullueshëm jeni, por nuk ka asgjë të keqe kur pranoi se keni punuar shumë për suksesin tuaj.

**VIRGJERESHA**  
Parashikohet të jetë një ditë pozitive pa ndonjë arsye të veçantë. Është aspekti planetar që ofron energji, e cila transmetohet pozitivisht mbi ju. Mos mendoni për asgjë tjetër, përveçse të jeni të gëzuar.

**PESHORJA**  
Sot aftësia juaj për të vlerësuar gjërat më të vogla në jetë do të ndihmojë jo vetëm ju, por edhe njerëzit për të cilët interesoheni më së shumti. Sa i përket aspektit profesional, mund të merrni lajme të mira.

**AKREPI**  
Nëse keni humbur besimin në fuqitë tuaja intuitive, mos u shqetësoni! Besimi juaj do të rivendoset me një zhvillim të pazakontë gjatë ditës. Kur të ndodhë, do të ndiheni mjaft mirë dhe i përmbsbur.

**SHIGJETARI**  
A e gjeni veten të tërhequr pas një personaliteti të kundërt? Njerëzit me energji të ndryshme mund të jenë hipnotikë dhe tërheqës. Por këto dallime, gjithashtu, mund të çojnë në shumë konflikte. A jeni gati për këtë?

**BRICJAPI**  
Duhet të përqipeni të përfatonit me gjithë zemër ndryshimin dhe idetë e panjohura sot rreth jush. Ato do tju tregojnë një mënyrë më të mirë për të bërë diçka për të cilin keni shumë interes. Çdo herë që përballeni me diçka që ju duket intriguess, ndiqeni atë deri në fund!

**UJORI**  
Femrat do të jenë një forcë e shquar në ditën tënde, prandaj dëgjoi zërat më të buta rreth jush me një vëmendje më të madhe sesa zakonisht. Përpqipuni të kuptoni kompleksitetin në gjërat që ju rrethojnë.

**PESHQIT**  
Të rrethosh veten me njerëzit që ju duan është diçka që të gjithë e duan, por zakonisht është një koncept mjaft ambicioz. Sot energjia rreth jush është më pozitive se kurrë, kështu që është gjeni kohë për një mbrëmje relaksuese.

**TRAJNERI I KUKËSIT**



**Gjoka: Triumf me Tiranën për vendin e dytë**

Është momenti që Kukësi të riformatojë dhe një herë idetë, është momenti të harrojnë Partizanin dhe të përqendrohen tek objektivat real, hipotekimi i vendit të dytë në kampionat dhe kualifikimi për në finalen e Kupës, gjithçka për Gjokën fillimisht kalon nga Tirana, kundërshtari i tyre i radhës: "Gjërat po bëhen më të vështira. Ne kemi përcaktuar objektivat, duhet të blindojmë vendin e dytë dhe të shkojmë në finalen e Kupës. Tirana është në moment të vështirë, e dimë që nesër do të jenë agresiv. Kjo do të rrisë më shumë adrenalinën e ndeshjes. Kemi objektivat tona dhe duhet patjetër rezultat pozitiv. Shkalla e vështirësisë së takimit është maksimale".

**TRAJNERI I TIRANËS**



**Mema: Fitorja na duhet për vete, jo për Partizanin**

Ardian Mema kërkon tri pikët sot në përballjen që bard zheblutë do të kenë me Kukësin në "Selman Stërmasi". "Na duhen pikët, jo për gjëra të tjera. Mund të luajmë keq dhe të fitojmë. Nuk flas dot për avantazh, Kukësi ka lojtarë shumë cilësorë. Fusha do e tregojë se kush do jetë ekipi me më shumë ekuilibër dhe më të përqendruar. Do isha i kënaqur me rikthimin e tifozëve dhe Ngo'o. E kam thënë edhe njëherë, pasi kemi fituar me Kukësin fazën e tretë, dhe një nga pyetje që m'u bë ishte se po nxirrni Partizanin kampion. Thashë një nga gjërat që nuk dua ta bëj kurrë është ta nxjerr kampion Partizanin. Kampionati i tillë është me pikë. Ndonjëherë ju bën nder, ndonjëherë jo. Ata i kanë pikët me meritë".

Tekniku mbyll diskutimin për futbollin e tavolinave: Nuk varet nga ne, por nga dobësitë e tyre

**M**e titullin kampion në dorë, por me matematikën që ende nuk e lejon të festojë, Partizani kërkon të kalojë sa më shpejt edhe këtë pengesë për të zyrtarizuar trofeun që i mungon për më shumë se çerekshkullit. Pas një jave pushim, ku mori tri pikët në tavolinë dhe nga televizioni shijoi humbjen e rivalëve direkt, Skënder Gega dhe të besuarit e tij kthehen në fushën e lojës për transfertën kundër Kastriotit. "Nuk besoj se ka ndeshje të lehta. Jemi përgatitur edhe për fushën. As unë s'kam qenë i kënaqur. Janë ca gjëra s'mund t'i rregullojmë tani. Do të doja që edhe Kruja të kishte fushë më të mirë. Jemi besimplotë, e kemi potencialin", ka thënë Gega në konferencën zyrtare për mediat. Trajneri i Partizanit është përgjigjur sërish aludimeve për aleanca në këtë fazë të sezonit, të ngritura kryesisht nga Tirana. "Kam çuar një mesazh "Fair Play". Kundërshtarët shekullorë i duam në ligë. Nuk varet nga ne. Është puna e tyre, janë dobësitë e tyre. Jam trajner i Partizanit dhe do të ngelem i Partizanit edhe jashtë fushës. Tirana i jep bukuri, edhe Dinamo, edhe Shkodra. Do të doja të ishin gjithmonë në ligë. Mendoj që derbi i fundit është interesant. Do mendohej për maksimumin. Në konferencë për shtyp nuk bëjmë muhabet tavolinash. Është perceptimi i tij. Është e drejta e tij si t'i shpërndajë gjërat që i ndodhin në punë. Në Gjirokastër nuk është ekipi i parë dhe i fundit që kemi humbur. Nuk kam asnjë lloj koment", ka vijuar Gega. Duke iu kthyer çështjes titull, tekniku i skuadrës së kuqe vazhdon të presë matematikën, pavarësisht se rivalët direkt tashmë janë dorëzuar. "Ndoshta i shikojnë gjërat më me diplomaci. Kemi edhe 7 javë, shpresoj të jemi këtu përballë një fakti. Deri në momentin e fundit nuk do të them se jemi kampion. Tani kemi Krujën", ishin fjalët e Skënder Gegës. Pushimi i ka bërë mirë kryesuesëve të Superligës, që kanë rikuperuar disa lojtarë të rëndësishëm, teksa edhe Bruno Telushi është kthyer në skuadër pas operacionit.

# Gega pret ende matematikën: Partizani luan për vete

*Trajneri i të kuqeve kërkon suksesin ndaj Kastriotit*



**Ekipet bëjnë pazar mes tyre**

**Juve-Inter, merr jetë shkëmbimi Dibala-Ikardi**

Ishte folur edhe më parë, madje duke krijuar shumë polemika. Mauro Ikardi që transferohet te Juventus nuk është vetëm një fantazi dhe kjo mundësi pritet të kthehet sërish në skenë për të pëshpjelluar merkaton e verës. Të bindura për këtë janë mediat italiane. Sipas tyre, klubi juventin nuk ka hequr dorë nga mundësia për të transferuar sulmuesin e Interit. Në tavolinë janë disa opsione, por ajo që duket më e mundshme për të finalizuar këtë operacion lidhet me shkëmbimin e Mauro Ikardi me Paulo Dibala. Ky skenar mbështetet edhe në situatën aspak të mirë që po kalojnë dy futbollistët në skuadrat e tyre. Raporti i vështirë i Ikardit me Interin tashmë është i njohur. Atij iu hoq shiriti i kapitenit, ndërsa edhe pas rikthimit në fushë, një pjesë e mirë e tifozëve zikaltrë është kundër tij. Nga ana tjetër, Paulo Dibala ka humbur shkëlqimin te Juventus dhe tashmë konsiderohet si një zgjedhje e dytë. Ky vlerësim nuk i pëlqen aspak sulmuesit, që po mendon largimin, edhe pse kalimi te Interi nuk është një opsion që pritet me entuziazëm nga vetë futbollisti. Në këtë shkëmbim të mundshëm nuk duhet nënvlerësuar roli i drejtuesëve të dy klubeve. Fabio Paratici, drejtori sportiv i Juventusit nuk e ka fshehur asnjëherë stimën e tij për Mauro Ikardi, ashtu si administratori i deleguar i Interit, Beppe Marota, që me Paulo Dibala ka një raport të shkëlqyer.

**Favorizohen kryeqytetasit**


**Federata ndryshon kalendarin për Ajaksin, 'tërbohet' PSV**



noit ditën e martë. Por ky vendim i federatës ka sjellë shumë pakënaqësi në disa prej skuadrave holandeze dhe sidomos PSV Ajndhoveni, e cila është në luftë direkte për titullin kampion me ekipin amsterdames dhe ky favorizim i palës tjetër nuk u ka pëlqyer aspak. Gjithsesi federata e ka prerë shkurt këtë diskutim duke thënë se bëhet fjalë për të mirën e futbollit holandez.

**R**ikthimi i një skuadere holandeze në gjysmëfinalen e Champions League pas një mungese 14 vjeçare që pas edicionit të vitit 2004-2005, kur PSV Ajndhoven u eliminua nga Milani, ka gëzuar pa masë federatën holandeze, e cila ka vendosur t'i bëjë një nder të jash-tëzakonshëm Ajaksit të Amsterdemit. Federata ka vendosur të zhvendosë kalendarin vendës duke i dhënë kohë Ajaksit për të përgatitur gjysmëfinalen e parë kundër Totenhemit, me javën përkatëse, që do të rikuperohet më 15 maj. Ajaksi rikthehet në një gjysmëfinale të Champions League për herë të parë që prej vitit 1997, ndërsa finalen e fundit e ka luajtur në vitin 1996 pikërisht kundër Juventusit, ekip që e elimi-

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

- Niven që qe aktor.
- Little... kryeqyteti i Arkansas.
- Janë tek në lakër.
- Nuk ka akoma një bebe.
- Kufizojnë katete.
- Penn aktor.
- Hector që shkroi Pa familje.
- Thahen me bonifikime.
- Mbyllin takimin.
- Ndërmarrje industriale Mat.
- Mbylljen me epilog.
- Tregohen indiferentë dhe aspak të gjallë.
- Ishin sandalet e lëkurëkuqve.
- Njëlloj për latinët.
- Eshhtë vend si Katari.
- Pupi regjisor.
- Janë strehat e çobanëve.
- Eshhtë centrali si Chernobyl.

- Fillojnë një argument.
- Të parat në stadium.
- Mund të sjellin shi.
- Kështu fillon Odisea.
- Një mund të jetë emërore.
- Thirrej edhe kështu Persefoni.
- Ai dhe ajo.
- E ka lënë atë që s'ka fuqi
- Para es Salaam.
- Ylli i Londrës.
- Eshhtë syzë... në komo.

**VERTIKALI**

- Hyskja aktor.
- Kush e thotë lutet.
- Një tis mjegulle.
- Maiden që këndojnë.
- Gjysmë rekord.
- Antonio skulptori i famshëm.
- David regjisor.
- Janë brinjë në skuadër.
- Ruan në kufij.
- Mban mikrofonin.
- Janë edhe ato të fytyrës.
- Qureshin edhe Eumenide.
- Demek pa kufij.
- Mund të jetë atomike.
- Qyteti i përjetshëm.
- Kitara e Ravi Shankar.
- Janë katrore në sipërfaqe.
- Një fjalë si goja.
- Pak daktilografi
- Eshhtë si divan.
- Një pjesë e amerikanëve.
- Bernhardi që qe aktore.
- Eshhtë infeksion në veshë.
- Një mund të jetë unik
- Gjysma e sasisë.
- Pak marramendëse.
- Eshhtë dhomë.
- Fillojnë takimin.
- Në fund majtas.
- Të fund në manastir.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


- E bardhë ajo Moby Dick.
- Fillojnë amplifikimin.
- Eshhtë vit që parashikohet.
- Mbyllin pamjen.
- U printe jetëçerëve.
- Thurman aktore.
- Një reaksion në provëz.
- Një sport me brez të zi.
- Në fund të fundit.
- Janë në gjyq.
- I është hequr të dënuarit.
- Eshhtë shahu i fundit
- Janë fletë trëndafil.
- Kufizojnë një metër.
- Tregojnë pallate në miniaturë.
- Një fjalë pa shkak.
- Janë përloqarite.
- Mbyllin një dritare.
- Të parat në muzg.

**VERTIKAL**


- Ishte titulli i Hiro Hitos.
- Ekberg aktore.
- Eshhtë skuadra.
- Dy asa.
- Binjaket në klasa.
- Qe duhet sajduris.
- Nuk i bihet me kokë.
- Sharif aktor.
- Janë organet e taksave.
- Me Haensel në përrallat e vëllezërve Grimm.
- Vihen për të mbyllur.
- Janë vegla.
- Eshhtë medalja e të parit.
- I dhimbset frikacakut.
- Mund të jetë mbi xhiro.
- Eshhtë llahtar.
- Janë inate të akumuluar.
- Eshhtë vëlla i gruas.
- Një tip për të këcyer.
- Edoard piktor.
- Lumë në Francë.
- Janë djemtë e... nënës.
- Lindi Akilin.
- Kodi i celularit.
- Mbledh basket separatistë
- Një është edhe Egjue.
- Fillojnë një metodë.
- Dy anët e një neni.
- Fillojnë ofensivën.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

		4		5	8		7	3
2		7						8
		6	2		7	5		
4	1			8	3			
	3		1	6	5			
		7	9				2	1
		5	3		1	4		
6						9		2
8	7		9	4		1		

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

2	3	5	1	7	9	4	8	6
4	6	9	2	8	5	3	7	1
8	7	1	3	4	6	2	5	9
7	8	6	4	9	1	5	2	3
3	9	4	5	2	7	6	1	8
1	5	2	6	3	8	9	4	7
5	2	8	7	6	3	1	9	4
6	4	7	9	1	2	8	3	5
9	1	3	8	5	4	7	6	2

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

*Argëtim filozofik*

- "Një nga kënaqësitë më të mëdha në jetë, është që të bësh gjëra që të tjerët thonë se ju nuk mundeni".

- Kushdo që dëshiron, gjen kohë. Kushdo që nuk dëshiron, gjen justifikime.

- "Njeriu udhëton në jetën e tij duke u justifikuar për të kaluarën, duke u ankur në lidhje me të tashmen, dhe i frikësuar për të ardhmen."

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

2	11	2	11	1	7	1	13	4	1	3		
4	6	2	15	1	3	6		4	1	3	6	
5	2	7	8		7	2	11	1	8	1	3	
	17	1	13	6	11	9	5	1	3	5		
17			1	7	9	13	9	12	6	2	4	
5	2		8	9	7	1	12	1	3	11	1	
3	13	3	1	13	2		2	3	2	2	15	
13	2	13	3	1	16	3	3	8	2	5	2	
7	13	1		6		6	8	6	5	1	3	
6		15	2	13	2	7		2	1	7		
15	B	A	R	I		2	5	1	3	13	1	4
1		15	2	16	3	6		2	17	2	3	6

H	A	R	K	D	B	M	I	K		
A	B	I	B	I	M	O	R	E	A	
R	O	S	S	L	A	R	R	O	M	
A	N	A	D	E	R	I	M	I	A	
B	E	H	E	M	A	T	O	M	A	T
E	H	A	B	A	N	E	R	A	A	
L	E	R	A	E	A	N	E	T		
A	R	B	I	T	E	R	L	G		
T	A	R	A	N	S	A	R	T		
K	A	N	T	A	T	A	T	R	A	
A	I	A	G	A	B	A	R			
B	I	K	B	R	A	D	B	E		

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQJVE TË NUMRIT TË KALUAR**

O	R	A	K	U	L	L	I	P	R	A	G	U
P	A	T	R	I	O	T	K	I	L	M	E	R
E	L	I	A	F	O	R	A	R	I			
R	F	V	I	K	T	I	M	A	T	M	A	
A	M	A	R	R	E	Z	I	T	E	A	H	
M	E	T	E	O	R	I	T	E	T	H		
R	O	M	A	N	T	I	K	E	T	M	A	E
E	T	O	E	O	T	T	K	A	T	E		
P	O	R	T	N	A	L	E	N	N	I	P	
A	R	I	A	E	L	E	O	R	I			
R	E	A	L	E	T	O	T	A	L	E		
T	T	L	E	S	T	E	T	I	K	A		
I	A	T	A	I	M	D	O	R	E	A		
U	R	A	T	P	A	P	A	O	D	E	T	
N	E	R	E	U	K	O	L	E	L	M		
E	N			D	A	L	I	L	A	I	O	
L	E	E	M	A	R	A	D	O	N	A	S	
I	P	R	O	V	O	K	A	T	O	R	F	
V	I	O	L	I	N	E				P	E	
M	A	T	E	L	D	A	N	A	D	A	R	
A	L	E	N	A	T	K	O	F	E	L	I	N
K	T	A	R	A	B	L	L	E	D	I	K	E
S	H	E	M	R	A	E	R	O	T	I	K	E
I	N	T	R	I	G	A	A	L	I	U		

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**



*Thënie të mençura*

- "Nga njëherë keni nevojë për tu larguar nga vetja për të parë gjërat më qartë."
- Të mençurit flasin, sepse kanë diçka për të thënë.
- Budallenjtë flasin, sepse diçka duhet të thonë."
- Njohuria është krenare që di atë shumë.
- Mençuria ka turp që nuk di më shumë.

